



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 173/7 prot.

Datë 18.03.2026

V E N D I M

Nr. 405/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës

*Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Mbetjen të skualifikuar të ofertës së operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit*

Ankimues:

Operatori ekonomik “ERALD” SHPK me NIPT J74517205P, dhe me adresë: *Rruga Nacionale Tiranë – Fushë Krujë, km 13, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30, Qereke, Nikël, Krujë, Durrës.*

Operatori ekonomik “MUCA” SHPK me NIPT: K01421002H, dhe me adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, km.13, fshati Picar, Vorë.*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.5. Operatori ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.07.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “*Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025*”, me fond limit 37,618,436 (*tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (*treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë*) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “*Blerje orendish për mobilim*”, me fond limit të lotit 32,216,511 (*tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (*treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë*) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

II.2. Në datë 31.07.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 25.08.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	“MUCA” sh.p.k	17,710,500	leke	skualifikuar
2	“ERALD” sh.p.k	21,316,800	leke	skualifikuar
3	“E M K O ” sh.p.k	21,595,000	leke	skualifikuar
4	“KLAME” sh.p.k	21,981,500	leke	skualifikuar
5	“URBAN FURNITURE” sh.p.k	22,192,800	leke	kualifikuar
6	“BOLT” sh.p.k	25,213,628	leke	skualifikuar
7	“Eduart Xhixha” Person Fizik	25,772,500	leke	kualifikuar
8	“SHAGA.” sh.p.k	31,263,015	leke	kualifikuar
9	“ERZENI/SH” sh.p.k	31,572,670	leke	skualifikuar
10	“Alpha Furniture” sh.p.k	33,131,984	leke	skualifikuar

II.4. Në datën 25.08.2025, operatori ekonomik “MUCA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “MUÇA” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, ku kërkohet: 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi të lotit 1. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Në përmbushje të kësaj kërkesë OE “MUÇA” shpk ka deklaruar se nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi por është distributor i autorizuar i prodhuesve “Goldsit Office Furniture” dhe “3A-PROFILE” shpk, si dhe ka ngarkuar disa broshura me logo të operatorëve të deklaruar. Katalogët e paraqitur nuk janë të vulosur apo të nënshkruar nga prodhuesit e deklaruar, çka do të provonte se janë lëshuar prej tyre.

Për më tepër, për artikujt e mëposhtëm:

Dollap metalik me kanata rrëshqitëse strukturë e fortë, hapësirë efikase

Raft metalik për dosje strukturë e qëndrueshme dhe përdorim funksional

Raft metalik arkivimi strukturë e qëndrueshme me sergjenë të rregullueshëm

Kasafortë sekrete strukturë metalike me mbrojtje të lartë dhe hapësirë të organizuar

OE ka deklaruar si prodhues shoqërinë “3A-PROFILE” shpk. Referuar ekstraktit tregtar të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk, me NUIS K71704022V rezulton se kjo shoqëri nuk është prodhuese për artikujt objekt prokurimi. Në vijim objekti i aktivitetit të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk marrë nga regjistri tregtar:

- Import-eksport i pjeseve te kembimit per mjete transporti dhe makineri te te gjitha llojeve. Import eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, profile hekuri, llamarine, hekur, çimento, tulla, etj. Projektimi, ndertimi i veprave civile, industriale, turistike, restaurime, ndertime rrugore, ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime hidroteknike, punime mbrojtese e sistemim hidraulik, etj. Import dhe tregti artikuj ushqimor me shumice dhe pakice.

Gjithashtu edhe në Ëeb-site e shoqërisë “3A-PROFILE” shpk (<https://ëëë.3a-profile.al/>) nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë artikujt objekt prokurimi. Ndërsa, për sa i përket shoqërisë tjetër të deklaruar si prodhuese “Goldsit Office Furniture”, duke qenë se është shoqëri Turke nuk është e mundur të kontrollohet nëse ka në objektin e saj prodhimin e artikujve objekt prokurimi. Referuar katalogut të artikujve që kjo shoqëri prodhon/tregon, ngarkuar në ëeb-site e shoqërisë (<https://ëëë.goldsit.com/en/category/office-furniture>), nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë disa nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht: → Shtrat vizite për infermerinë – strukturë metalike dhe mbështetje ergonomike → Varëse rrobash metalike – model “koka e priftit” Gjithashtu, edhe për artikujt e tjerë referuar katalogëve online të shoqërisë “Goldsit Office Furniture” rezulton se specifikimet teknike të artikujve në katalogët e publikuar online nuk plotësojnë kërkesat teknike të artikujve të kërkuar. Në konkluzion OE “MUÇA” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, pasi malli i ofruar nuk plotëson specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi.”.

II.5. Në datën 25.08.2025, operatori ekonomik “ERALD” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik “Erald” shpk nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.3 pasi katalogu i paraqitur ne SPE nuk plotëson kushtet formale dhe substanciale të parashikuara për këtë tipologji dokumentacioni.

Konkretisht katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton te mos jete i firmosur dhe i vulosur. Në kushtet kur OE ne kete procedure prokurimi eshte paraqitur si prodhues eshte detyrimi i tij qe katalogu te paraqitet i firmosur dhe i vulosur duke konfirmuar ne kete menyre autenticitetin qe ky eshte katalog i tij.

- Parimi i Autenticitetit dhe Originalitetit të Dokumenteve

Çdo dokument i paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë të prokurimit publik duhet të jetë origjinal dhe të reflektojë kapacitetet reale të tij. Në rastin konkret, katalogu i paraqitur është thjesht një riprodhim “copy-paste” i specifikimeve teknike të shpallura nga organi qendror blerës. Ky dokumentacion nuk demonstroi aftësi teknike, kapacitet prodhimi apo zotërim të produkteve, por vetëm një përsëritje mekanike e kushteve të tenderit. Për sa më sipër, katalogu i paraqitur nuk ofron garanci për cilësinë dhe vërtetësinë e ofertës.

- Mungesa e Firmës dhe Vulës

Firma dhe vula zyrtare janë elementë juridikisht detyruar për të provuar vlefshmërinë e çdo dokumenti. Mungesa e tyre nënkupton që operatori ekonomik:

- Nuk merr përgjegjësi ligjore për përmbajtjen e katalogut.

- Nuk e konfirmon vërtetësinë e informacionit të paraqitur.
- Nuk garanton që dokumenti është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës.

Sipas praktikës ndërkombëtare dhe kombëtare, dokumentet pa nënshkrim dhe vulë nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe për pasojë janë të pavlefshme për vlerësim.

- Përdorimi i Vetës së Tretë në Tekst

Një element tjetër problematik është fakti që katalogu është hartuar në vetën e tretë (p.sh. “produkti ofron...”, “Në planin e punës të jetë e hapur.....”), dhe jo në vetën e parë (p.sh. “kompania jonë ofron apo merr persiper te prodhoje...”, “Në planin e punës do të jetë e hapur.....”). Ky fakt tregon se operatori ekonomik nuk e ka përshtatur dokumentin për të dëshmuar kapacitetin e tij si prodhues apo furnizues, por ka riprodhuar pa reflektim tekstin bazë. Ky mungesë personalizimi ngre dyshime serioze mbi aftësinë reale të tij për të ofruar mallrat e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Sipas rregullave të miratuara për paraqitjen e katalogëve:

- Operatorët duhet të dorëzojnë katalogë të përgatitur posaçërisht, që përmbajnë përshkrime teknike të personalizuar.

Kompania merr persiper te prodhoje apo furnizoje mallrat objekt kontrate.

- Katalogu duhet të jetë i firmosur, i vulosur dhe i pajisur me informacion të plotë mbi prodhuesin, furnizuesin, dhe karakteristikat e artikujve.

Në mungesë të këtyre elementeve, dokumenti nuk përmbush standardet minimale për t’u konsideruar katalog i vlefshëm.

Në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik dhe rregulloret në fuqi mbi barazine e operatoreve ekonomik pjesmarres, standardizimin e katalogëve, operatori ekonomik duhet të skualifikohet për shkak se:

- Nuk ka përmbushur kriteret e paraqitjes së dokumenteve (mungesë firme dhe vule).
- Nuk ka ofruar katalog origjinal që dëshmon kapacitet teknik.
- Ka dështuar të personalizojë ofertën sipas kërkesave ligjore dhe teknike.

Në bazë të të gjitha sa më sipër, katalogu i dorëzuar konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm. Operatorit ekonomik i mungon përgjegjësia ligjore, origjinaliteti dhe vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur. Për rrjedhojë, ky operator shpallet i skualifikuar nga procedura, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, si dhe me standardet e transparencës, barazisë dhe integritetit të procesit të prokurimit.”.

II.6. Në datën 25.08.2025, operatori ekonomik “KLAME” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “Klame” shpk nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, të përcaktuar në piken 2.3.3 pasi katalogu i paraqitur në SPE nuk plotëson kushtet formale dhe substanciale të parashikuara për këtë tipologji dokumentacioni.

Konkretisht katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton të mos jetë i firmosur dhe i vulosur. Në kushtet kur OE në këtë procedurë prokurimi është paraqitur si prodhues është

detyrimi i tij që katalogu të paraqitet i firmosur dhe i vulosur duke konfirmuar në këto mënyra autenticitetin që ky është katalog i tij.

Parimi i Autenticitetit dhe Originalitetit të Dokumenteve

Çdo dokument i paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë të prokurimit publik duhet të jetë origjinal dhe të reflektojë kapacitetet reale të tij. Në rastin konkret, katalogu i paraqitur është thjesht një riprodhim “copy-paste” i specifikimeve teknike të shpallura nga organi qendror blerës. Ky dokumentacion nuk demonstroi aftësi teknike, kapacitet prodhimi apo zotërim të produkteve, por vetëm një përsëritje mekanike e kushteve të tenderit. Për sa më sipër, katalogu i paraqitur nuk ofron garanci për cilësinë dhe vërtetësinë e ofertës.

Mungesa e Firmës dhe Vulës

Firma dhe vula zyrtare janë elementë juridikisht detyrues për të provuar vlefshmërinë e çdo dokumenti. Mungesa e tyre nënkupton që operatori ekonomik:

- Nuk merr përgjegjësi ligjore për përmbajtjen e katalogut.
- Nuk e konfirmon vërtetësinë e informacionit të paraqitur.
- Nuk garanton që dokumenti është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës.

Sipas praktikës ndërkombëtare dhe kombëtare, dokumentet pa nënshkrim dhe vulë nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe për pasojë janë të pavlefshme për vlerësim.

Përdorimi i Vetës së Tretë në Tekst

Një element tjetër problematik është fakti që katalogu është hartuar në vetën e tretë (p.sh. “produkti ofron...”, “Në planin e punës të jetë e hapur.....”), dhe jo në vetën e parë (p.sh. “kompania jonë ofron apo merr persiper të prodhojë...”, “Në planin e punës do të jetë e hapur.....”). Ky fakt tregon se operatori ekonomik nuk e ka përshtatur dokumentin për të dëshmuar kapacitetin e tij si prodhues apo furnizues, por ka riprodhuar pa reflektim tekstin bazë. Ky mungesë personalizimi ngre dyshime serioze mbi aftësinë reale të tij për të ofruar mallrat e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Sipas rregullave të miratuara për paraqitjen e katalogëve:

Operatorët duhet të dorëzojnë katalogë të përgatitur posaçërisht, që përmbajnë përshkrime teknike të personalizuara.

Kompania merr persiper të prodhojë apo furnizojë mallrat objekt kontrate.

Katalogu duhet të jetë i firmosur, i vulosur dhe i pajisur me informacion të plotë mbi prodhuesin, furnizuesin, dhe karakteristikat e artikujve.

Në mungesë të këtyre elementeve, dokumenti nuk përmbush standardet minimale për t’u konsideruar katalog i vlefshëm.

Në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik dhe rregulloret në fuqi mbi barazine e operatoreve ekonomik pjesëmarrës, standardizimin e katalogëve, operatori ekonomik duhet të skualifikohet për shkak se:

- Nuk ka përmbushur kriteret e paraqitjes së dokumenteve (mungesë firme dhe vule).
- Nuk ka ofruar katalog origjinal që dëshmon kapacitet teknik.
- Ka dështuar të personalizojë ofertën sipas kërkesave ligjore dhe teknike.

Në bazë të të gjitha sa më sipër, katalogu i dorëzuar konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm. Operatorit ekonomik i mungon përgjegjësia ligjore, origjinaliteti dhe vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur. Për rrjedhojë, ky operator shpallet i skualifikuar nga procedura, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, si dhe me standardet e transparencës, barazisë dhe integritetit të procesit të prokurimit”.

II.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 01.09.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “*URBAN FURNITURE*” SHPK.

II.8. Në datën 09.09.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5777, datë 09.09.2025 dhe numër protokoll nr. 2418/2025, datë 09.09.2025 e operatorit ekonomik “*ERALD*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*ERALD*” SHPK, si dhe kërkon mbetjen të skualifikuar të ofertës së operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2418/1, datë 10.09.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*ERALD*” SHPK, si dhe kërkon mbetjen të skualifikuar të ofertës së operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10 . Me shkresën nr. 2034/22 prot, datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2418/2 prot, datë 22.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 93/2025*”, datë 19.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.11. Në datë 22.09.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2034/22 prot, datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2418/3 prot, datë 22.09.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 93/2025*”, datë 19.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.12. Në datën 10.09.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5785, datë 10.09.2025 dhe numër protokoll nr. 2430/2025, datë 10.09.2025 e operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2430/1, datë 10.09.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14 . Me shkresën nr. 2034/20 prot, datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2430/2 prot, datë 22.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 92/2025”, datë 19.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.15. Në datë 22.09.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2034/20 prot, datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2430/3 prot, datë 22.09.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 92/2025”, datë 19.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.16. Në datën 10.09.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5795, datë 10.09.2025 dhe numër protokoll nr. 2446/2025, datë 11.09.2025 e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe kërkon mbetjen të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “MUCA” SHPK, “ERALD” SHPK dhe “E M K O” SHPK dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK Ee operatori ekonomik “ERALD” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2446/1, datë 12.09.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, si dhe kërkon mbetjen të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “MUCA” SHPK, “ERALD” SHPK dhe “E M K O” SHPK dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK Ee operatori ekonomik “ERALD” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.18. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “URBAN FURNITURE” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i

ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2446/2 prot., datë 17.09.2025.

II.19 . Me shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/3 prot, datë 18.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.20. Në datë 18.09.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/4 prot, datë 18.09.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.21. Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5777, datë 09.09.2025 dhe numër protokolli nr. 2418/2025, datë 09.09.2025 të operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, me Vendimin nr. 301/2026, datë 24.02.2026, të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5785, datë 10.09.2025 dhe numër protokolli nr. 2430/2025, datë 10.09.2025 të operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, me Vendimin nr. 301/2026, datë 24.02.2026 dhe të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5795, datë 10.09.2025 dhe numër protokolli nr. 2446/2025, datë 11.09.2025 të operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, me Vendimin nr. 1488/2025, datë 21.10.2025 ka vendosur:

Vendos:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*
- 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin*

2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.
6. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK.
9. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK.

10. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.

11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

12. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.22. Komisioni i Prokurimit Publik në datën 10.11.2025 me iniciativën e tij me Vendimin nr. 1635/2025, datë 10.11.2025 korrigoji Vendimin nr. 1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë vijon:

Vendos

II.1. Të korrigojë pikën I.7, të seksionit “Vlerësimi paraprak”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

I.7. Operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

BËHET:

I.7. Operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Të korrigojë pikën II.19 dhe pikën II.20, të seksionit “Rrethanat e çështjes”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

II.19. Me shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/3 prot, datë 18.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.20. Në datë 18.09.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/4 prot, datë 18.09.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

BËHET:

II.19. Me shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/3 prot, datë 18.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ ...

II.1. Në datën 09.09.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokollit 2446/2025, datë 09.09.2025 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2025/5795, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaqme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e 68 ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE” nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datë 12.09.2025 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën si dhe me vetë formularin e ankesës.

Plotësimi i këtyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se përderisa operatori ekonomik ankimues “KLAME” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotësojë mangësitë e konstatuara lidhur me elementët përmbajtësorë të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

VENDOSI

- 1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.*

II.20. Në datë 18.09.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/4 prot, datë 18.09.2025, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ ...

II.1. Në datën 09.09.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokollit 2446/2025, datë 09.09.2025 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2025/5795, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaqme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e 68 ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE” nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datë 12.09.2025 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën si dhe me vetë formularin e ankesës.

Plotësimi i këtyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se përderisa operatori ekonomik ankimues “KLAME” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotësojë mangësitë e konstatuara lidhur me elementët përmbajtësorë të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

VENDOSI

- 1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.*

II.3. Të korrigjojë pikën III.1. dhe pikën III.1.4., të seksionit “ Rrethanat e çështjes”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ERALD” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Erald” shpk nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, të përcaktuar në piken 2.3.3 pasi katalogu i paraqitur ne SPE nuk plotëson kushtet formale dhe substanciale të parashikuara për këtë tipologji dokumentacioni.

Konkretisht katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton te mos jete i firmosur dhe i vulosur. Në kushtet kur OE ne kete procedure prokurimi eshte paraqitur si prodhues eshte detyrimi i tij qe katalogu te paraqitet i firmosur dhe i vulosur duke konfirmuar ne kete menyre autenticitetin qe ky eshte katalog i tij.

- **Parimi i Autenticitetit dhe Origjinalitetit të Dokumenteve**

Çdo dokument i paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë të prokurimit publik duhet të jetë origjinal dhe të reflektojë kapacitetet reale të tij. Në rastin konkret, katalogu i paraqitur është thjesht një riprodhim “copy-paste” i specifikimeve teknike të shpallura nga

organi qendror blerës. Ky dokumentacion nuk demonstroi aftësi teknike, kapacitet prodhimi apo zotërim të produkteve, por vetëm një përsëritje mekanike e kushteve të tenderit. Për sa më sipër, katalogu i paraqitur nuk ofron garanci për cilësinë dhe vërtetësinë e ofertës.

○ **Mungesa e Firmës dhe Vulës**

Firma dhe vula zyrtare janë elementë juridikisht detyrues për të provuar vlefshmërinë e çdo dokumenti. Mungesa e tyre nënkupton që operatori ekonomik:

- Nuk merr përgjegjësi ligjore për përmbajtjen e katalogut.
- Nuk e konfirmon vërtetësinë e informacionit të paraqitur.
- Nuk garanton që dokumenti është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës.

Sipas praktikës ndërkombëtare dhe kombëtare, dokumentet pa nënshkrim dhe vulë nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe për pasojë janë të pavlefshme për vlerësim.

○ **Përdorimi i Vetës së Tretë në Tekst**

Një element tjetër problematik është fakti që katalogu është hartuar në vetën e tretë (p.sh. “produkti ofron...”, “Në planin e punës të jetë e hapur.....”), dhe jo në vetën e parë (p.sh. “kompania jonë ofron apo merr persiper te prodhoje...”, “Në planin e punës do të jetë e hapur.....”). Ky fakt tregon se operatori ekonomik nuk e ka përshtatur dokumentin për të dëshmuar kapacitetin e tij si prodhues apo furnizues, por ka riprodhuar pa reflektim tekstin bazë. Ky mungesë personalizimi ngre dyshime serioze mbi aftësinë reale të tij për të ofruar mallrat e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Sipas rregullave të miratuara për paraqitjen e katalogëve:

- Operatorët duhet të dorëzojnë katalogë të përgatitur posaçërisht, që përmbajnë përshkrime teknike të personalizuar.

Kompania merr persiper te prodhoje apo furnizoje mallrat objekt kontrate.

- Katalogu duhet të jetë i firmosur, i vulosur dhe i pajisur me informacion të plotë mbi prodhuesin, furnizuesin, dhe karakteristikat e artikujve.

Në mungesë të këtyre elementeve, dokumenti nuk përmbush standardet minimale për t’u konsideruar katalog i vlefshëm.

Në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik dhe rregulloret në fuqi mbi barazine e operatoreve ekonomik pjesmarres, standardizimin e katalogëve, operatori ekonomik duhet të skualifikohet për shkak se:

- Nuk ka përmbushur kriteret e paraqitjes së dokumenteve (mungesë firme dhe vule).
- Nuk ka ofruar katalog origjinal që dëshmon kapacitet teknik.
- Ka dështuar të personalizojë ofertën sipas kërkesave ligjore dhe teknike.

Në bazë të të gjitha sa më sipër, katalogu i dorëzuar konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm. Operatorit ekonomik i mungon përgjegjësia ligjore, origjinaliteti dhe vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur. Për rrjedhojë, ky operator shpallet i skualifikuar nga procedura, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, si dhe me standardet e transparencës, barazisë dhe integritetit të procesit të prokurimit.”, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “MUCA” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: “Operatori ekonomik “MUÇA” shpk **nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, ku kërkohet:** 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/

fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi të lotit 1. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Në përmbushje të kësaj kërkesë OE “MUÇA” shpk ka deklaruar se nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi por është distributor i autorizuar i prodhuesve “Goldsit Office Furniture” dhe “3A-PROFILE” shpk, si dhe ka ngarkuar disa broshura me logo të operatorëve të deklaruar. Katalogët e paraqitur nuk janë të vulosur apo të nënshkruar nga prodhuesit e deklaruar, çka do të provonte se janë lëshuar prej tyre.

Për më tepër, për artikujt e mëposhtëm:

Dollap metalik me kanata rrëshqitëse strukturë e fortë, hapësirë efikase

Raft metalik për dosje strukturë e qëndrueshme dhe përdorim funksional

Raft metalik arkivimi strukturë e qëndrueshme me sergjenë të rregullueshëm

Kasafortë sekrete strukturë metalike me mbrojtje të lartë dhe hapësirë të organizuar

OE ka deklaruar si prodhues shoqërinë “3A-PROFILE” shpk. Referuar ekstraktit tregtar të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk, me NUIS K71704022V rezulton se kjo shoqëri nuk është prodhuese për artikujt objekt prokurimi. Në vijim objekti i aktivitetit të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk marrë nga regjistri tregtar:

- Import-eksport i pjeseve te kembimit per mjete transporti dhe makineri te te gjitha llojeve. Import eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, profile hekuri, llamarine, hekur, çimento, tulla, etj. Projektimi, ndertimi i veprave civile, industriale, turistike, restaurime, ndertime rrugore, ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime hidroteknike, punime mbrojtese e sistemim hidraulik, etj. Import dhe tregti artikuj ushqimor me shumice dhe pakice.

Gjithashtu edhe në Ëëbsite e shoqërisë “3A-PROFILE” shpk (<https://ëëë.3a-profile.al/>) nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë artikujt objekt prokurimi. Ndërsa, për sa i përket shoqërisë tjetër të deklaruar si prodhuese “Goldsit Office Furniture”, duke qenë se është shoqëri Turke nuk është e mundur të kontrollohet nëse ka në objektin e saj prodhimin e artikujve objekt prokurimi. Referuar katalogut të artikujve që kjo shoqëri prodhon/tregon, ngarkuar në ëëbsite e shoqërisë (<https://ëëë.goldsit.com/en/category/office-furniture>), nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë disa nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht: → Shtrat vizite për infermerinë – strukturë metalike dhe mbështetje ergonomike → Varëse rrobash metalike – model “koka e priftit” Gjithashtu, edhe për artikujt e tjerë referuar katalogëve online të shoqërisë “Goldsit Office Furniture” rezulton se specifikimet teknike të artikujve në katalogët e publikuar online nuk plotësojnë kërkesat teknike të artikujve të kërkuar. Në konkluzion OE “MUÇA” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, pasi malli i ofruar nuk plotëson specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi.”, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: **“Operatori ekonomik “Klame” shpk nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, të përcaktuar në piken 2.3.3 pasi katalogu i paraqitur ne SPE nuk plotëson kushtet formale dhe substanciale të parashikuara për këtë tipologji dokumentacioni.**

Konkretisht katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton te mos jete i firmosur dhe i vulosur. Në kushtet kur OE ne kete procedure prokurimi eshte paraqitur si prodhues eshte detyrimi i tij qe katalogu te paraqitet i firmosur dhe i vulosur duke konfirmuar ne kete menyre autenticitetin qe ky eshte katalog i tij.

Parimi i Autenticitetit dhe Origjinalitetit të Dokumenteve

Çdo dokument i paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë të prokurimit publik duhet të jetë origjinal dhe të reflektojë kapacitetet reale të tij. Në rastin konkret, katalogu i paraqitur është thjesht një riprodhim “copy-paste” i specifikimeve teknike të shpallura nga organi qendror blerës. Ky dokumentacion nuk demonstroi aftësi teknike, kapacitet prodhimi apo zotërim të produkteve, por vetëm një përsëritje mekanike e kushteve të tenderit. Për sa më sipër, katalogu i paraqitur nuk ofron garanci për cilësinë dhe vërtetësinë e ofertës.

Mungesa e Firmës dhe Vulës

Firma dhe vula zyrtare janë elementë juridikisht detyrues për të provuar vlefshmërinë e çdo dokumenti. Mungesa e tyre nënkupton që operatori ekonomik:

- *Nuk merr përgjegjësi ligjore për përmbajtjen e katalogut.*
- *Nuk e konfirmon vërtetësinë e informacionit të paraqitur.*
- *Nuk garanton që dokumenti është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës.*

Sipas praktikës ndërkombëtare dhe kombëtare, dokumentet pa nënshkrim dhe vulë nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe për pasojë janë të pavlefshme për vlerësim.

Përdorimi i Vetës së Tretë në Tekst

Një element tjetër problematik është fakti që katalogu është hartuar në vetën e tretë (p.sh. “produkti ofron...”, “Në planin e punës të jetë e hapur.....”), dhe jo në vetën e parë (p.sh. “kompania jonë ofron apo merr persiper te prodhoje...”, “Në planin e punës do të jetë e hapur.....”). Ky fakt tregon se operatori ekonomik nuk e ka përshtatur dokumentin për të dëshmuar kapacitetin e tij si prodhues apo furnizues, por ka riprodhuar pa reflektim tekstin bazë. Ky mungesë personalizimi ngre dyshime serioze mbi aftësinë reale të tij për të ofruar mallrat e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Sipas rregullave të miratuara për paraqitjen e katalogëve:

Operatorët duhet të dorëzojnë katalogë të përgatitur posaçërisht, që përmbajnë përshkrime teknike të personalizuara.

Kompania merr persiper te prodhoje apo furnizoje mallrat objekt kontrate.

Katalogu duhet të jetë i firmosur, i vulosur dhe i pajisur me informacion të plotë mbi prodhuesin, furnizuesin, dhe karakteristikat e artikujve.

Në mungesë të këtyre elementeve, dokumenti nuk përmbush standardet minimale për t’u konsideruar katalog i vlefshëm.

Në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik dhe rregulloret në fuqi mbi barazine e operatoreve ekonomik pjesmarres, standardizimin e katalogëve, operatori ekonomik duhet të skualifikohet për shkak se:

- *Nuk ka përmbushur kriteret e paraqitjes së dokumenteve (mungesë firme dhe vule).*
- *Nuk ka ofruar katalog origjinal që dëshmon kapacitet teknik.*
- *Ka dështuar të personalizojë ofertën sipas kërkesave ligjore dhe teknike.*

Në bazë të të gjitha sa më sipër, katalogu i dorëzuar konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm. Operatorit ekonomik i mungon përgjegjësia ligjore, origjinaliteti dhe vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur. Për rrjedhojë, ky operator shpallet i skualifikuar nga procedura, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, si dhe me standardet

e transparencës, barazisë dhe integritetit të procesit të prokurimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatorët ekonomikë ofertues “ERALD” SHPK, “MUCA” SHPK dhe “KLAME” SHPK kanë dorëzuar përkatësisht dokumentacionin, si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin e emërtuar “KATALOG.pdf”, i cili përmban një dokument me 36 (tridhjet e gjashtë) faqe, i botuar nën autoritetin shoqërisë “ERALD” SHPK me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “1.Nr2/ Recepton ne formë U-je; 2.Nr6/ Dollap metalik me kanata rrëshqitëse; 3.Nr15/ Dollap me dy kanata; 4.Nr21/ Raft metalik për arkivë; 5.Nr22/ Raft metalik për dosje (arshivë); 6.Nr25/ Raft për dosje, material MDF; 7.Nr27/ Raft për dosje (etazher); 8.Nr30/ Raft me çelësa; 9.Nr33/ Raft për bibliotekën; 10.Nr39/ Komodina dyshe (ushtari); 11.Nr40/ Komodinë zyre; 12.Nr50/ Kasaforta sekrete; 13.Nr68/ Shtrat vizite për infermierinë; 14.Nr70/ Karrige statike pa krahë mbështetës; 15.Nr71/ Karrige statike me krahë mbështetës; 16.Nr72/ Karrige jo statike me krahë mbështetës; 17.Nr73/ Karrige për rangun drejtues; 18.Nr74/ Karrige për kabinetet; 19.Nr75/ Kolltuqe komplet (3+2+1); 20.Nr76/ Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh); 21.Nr77/ Poltron pritje njëvendësh (kolltuk 1- vendësh); 22.Nr79/ Poltron rrotullues; 23.Nr92/ Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona; 24.Nr93/ Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona; 25.Nr105/ Tavolinë klase; 26.Nr110/ Tavolinë mence; 27.Nr113/ Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi; 28.Nr115/ Tavolinë zyre; 29.Nr116/ Tavolinë pune; 30.Nr118/ Tavolinë pune e thjeshtë; 31.Nr123/ 30 Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je; 32.Nr125/ Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe; 33.Nr126/ Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël; 34.Nr134/ Tavolinë me palosje; 35.Nr138/ Krevat tek; 36.Nr143/ Varëse rrobash (koke prifti) metalike dhe 37.Nr156/ Ekspozitorë.”.

Operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin e emërtuar “7-katalogje.pdf”, i cili përmban një dokument me 39 (tridhjet e nëntë) faqe, ku 4 (katër) faqe janë botuar nën autoritetin shoqërisë “XXX” SHPK me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “DOLLAP METALIK ME KANATA RRËSHQITËSE – STRUKTURË E FORTË, HAPËSIRË EFIKASE; RAFT METALIK PËR DOSJE – STRUKTURË E QËNDRUESHME DHE PËRDORIM FUNKSIONAL; RAFT METALIK ARKIVIMI – STRUKTURË E QËNDRUESHME ME SERGJENË TË RREGULLUESHËM dhe KASAFORTË SEKRETE – STRUKTURË METALIKE ME MBROJTJE TË LARTË DHE HAPËSIRË TË ORGANIZUAR”. ndërkohë që 35 (tridhjet e pesë) faqe janë botuar nën autoritetin shoqërisë “XXX” me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “RECEPTION MODERN ME SIPËRFAQE MELAMINE DHE QELQ TË TEMPERUAR; DOLLAP DOKUMENTESH ME KANATE – STRUKTURË MELAMINE DHE PËRFUNDIME CILËSORE; DOLLAP ELEGANT ME RAFTE MDF DHE KANATA XHAMI – FINITURË NATYRALE DHE DIZAJN PREMIUM; DOLLAP ME STRUKTURË MELAMINE – DIZAJN FUNKSIONAL DHE REZISTENCË E LARTË; RAFT PËR ÇELËSA ME DIZAJN ELEGANT DHE

MBROJTJE ME KANATA XHAMI – RIMESO ANIGRE DHE STRUKTURË MDF; LIBRARI E LARTË ME STRUKTURË DRURI MULTISTRAT – DIZAJN FUNKSIONAL DHE PËRFUNDIM NATYRAL; KOMODINË FUNKSIONALE ME STRUKTURË MELAMINE – DIZAJN MODERN DHE REZISTENCË E LARTË; KOMODINË ZYRE – STRUKTURË MELAMINE ME PËRFUNDIME CILËSORE; SHTRAT VIZITE PËR INFERMERINË – STRUKTURË METALIKE DHE MBËSHTETJE ERGONOMIKE; KARRIGE STATIKE PA KRAHË – STRUKTURË METALIKE DHE TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KARRIGE STATIKE ME KRAHË MBËSHTETËS – STRUKTURË METALIKE DHE TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KARRIGE ZYRE RROTULLUESE ME KRAHË MBËSHTETËS – ERGONOMI, LËVIZSHMËRI DHE KOMFORT; KARRIGE DREJTUESI – LËKURË ORIGJINALE DHE KOMODITET ERGONOMIK PREMIUM; KARRIGE PËR KABINETE – STRUKTURË DRURI AHU DHE TAPICERI ERGONOMIKE; KOLLUTQË KOMPLET (3+2+1); KOLLTUK PRITJE DYVENDËSH – DIZAJN MODERN ME TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KOLLTUK PRITJE NJËVENDËSH – STIL MODERN DHE KOMODITET ELEGANT; POLTRON RROTULLUES – ERGONOMI AVANCUAR DHE MEKANIZËM SINKRON; TAVOLINË MBLEDHJE DREJTUESI PËR 12 PERSONA – STRUKTURË MDF & KËMBË INOX; TAVOLINË MBLEDHJE DREJTUESI PËR 6 PERSONA – MDF PREMIUM DHE KËMBË INOKSI; TAVOLINË KLASË – STRUKTURË METALIKE DHE SYPRINË MELAMINE REZISTENTE; TAVOLINË MENCE – STRUKTURË METALIKE DHE SYPRINË MELAMINE REZISTENTE; TAVOLINË E VOGËL MESI – PËR ZYRA DREJTUESE STRUKTURË KROM & SYPRINË MDF; TAVOLINË ZYRE ME HARK LIDHËS DHE KOMODINË – STRUKTURË MELAMINE DHE DIZAJN FUNKSIONAL; TAVOLINË PUNE – STRUKTURË MELAMINE 32 MM DHE KANAL KABLLOR INTEGRUAR; TAVOLINË PUNE E THJESHTË – DIZAJN PRAKTIK ME ELEMENTË FUNKSIONALE; TAVOLINË PUNE NË FORMË L-JE – ZGJIDHJE ERGONOMIKE DHE FUNKSIONALE PËR AMBIENTE ZYRE; TAVOLINË DREJTUESI NË FORMË L-JE – MODUL I ZGJERUAR ME TAVOLINË MBLEDHJEJE; TAVOLINË DREJTUESI NË FORMË L-JE – MODUL I VOGËL; TAVOLINË ME PALOSJE – FUNKSIONALE DHE E LËVIZSHME; KREVAT TEK – STRUKTURË E FORTË DHE REHATI MAKSIMALE; VARËSE RROBSH METALIKE – MODEL “KOKA E PRIFTIT” dhe EKSPOZITOR DY-PANELESH ME XHEPA HORIZONTAL. ”.

Operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin e emërtuar “25 SKEDA TEKNIKE”, i cili përmban një dokument me 19 (nëntëmbëdhjetë) faqe, i botuar nën autoritetin shoqërisë “KLAME” SHPK me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “Reception në formë U-je; Dollap metalik me kanata rrëshqitëse; Dollap me dy kanata rrobash për zyra; Raft metalik për arkivë; Raft metalik për dosje (arshivë); Raft për dosje, material MDF; Raft për dosje (etazher); Raft me çelësa; Raft për bibliotekën; Komodina dyshe (ushtari); Komodinë zyre; Kasaforta; Shtrat vizite për infermierinë; Karrige statike pa krahë mbështetës Karrige jo statike me krahë mbështetës; Karrige për rangun drejtues; Karrige për kabinetet të thjeshta; Kolltuqe komplet (3+2+1); Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh); Poltron pritje njëvendësh (kolltuk1- vendësh); Poltron rrotullues; Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona; Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona; Tavolinë klase; Tavolinë mence; Tavolinë e vogël mes, drejtuesi; Tavolinë zyre; Tavolinë pune; Tavolinë pune e thjeshtë (Instruktori); Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je; Tavolinë drejtuesi në formë L-je e

madhe; Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël; Tavolinë me palosje; Krevat Tek; Varëse rrobash (koke prifti) metalike dhe Ekspozitorë.”.

BËHET:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “ERALD” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Erald” shpk nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.3 pasi katalogu i paraqitur ne SPE nuk plotëson kushtet formale dhe substanciale të parashikuara për këtë tipologji dokumentacioni.

Konkretisht katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik rezulton te mos jete i firmosur dhe i vulosur. Në kushtet kur OE ne kete procedure prokurimi eshte paraqitur si prodhues eshte detyrimi i tij qe katalogu te paraqitet i firmosur dhe i vulosur duke konfirmuar ne kete menyre autenticitetin qe ky eshte katalog i tij.

○ Parimi i Autenticitetit dhe Origjinalitetit të Dokumenteve

Çdo dokument i paraqitur nga një operator ekonomik në një procedurë të prokurimit publik duhet të jetë origjinal dhe të reflektojë kapacitetet reale të tij. Në rastin konkret, katalogu i paraqitur është thjesht një riprodhim “copy-paste” i specifikimeve teknike të shpallura nga organi qendror blerës. Ky dokumentacion nuk demonstroi aftësi teknike, kapacitet prodhimi apo zotërim të produkteve, por vetëm një përsëritje mekanike e kushteve të tenderit. Për sa më sipër, katalogu i paraqitur nuk ofron garanci për cilësinë dhe vërtetësinë e ofertës.

○ Mungesa e Firmës dhe Vulës

Firma dhe vula zyrtare janë elementë juridikisht detyrues për të provuar vlefshmërinë e çdo dokumenti. Mungesa e tyre nënkupton që operatori ekonomik:

- Nuk merr përgjegjësi ligjore për përmbajtjen e katalogut.
- Nuk e konfirmon vërtetësinë e informacionit të paraqitur.
- Nuk garanton që dokumenti është pjesë e dokumentacionit zyrtar të ofertës.

Sipas praktikës ndërkombëtare dhe kombëtare, dokumentet pa nënshkrim dhe vulë nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe për pasojë janë të pavlefshme për vlerësim.

○ Përdorimi i Vetës së Tretë në Tekst

Një element tjetër problematik është fakti që katalogu është hartuar në vetën e tretë (p.sh. “produkti ofron...”, “Në planin e punës të jetë e hapur.....”), dhe jo në vetën e parë (p.sh. “kompania jonë ofron apo merr persiper te prodhoje...”, “Në planin e punës do të jetë e hapur.....”). Ky fakt tregon se operatori ekonomik nuk e ka përshtatur dokumentin për të dëshmuar kapacitetin e tij si prodhues apo furnizues, por ka riprodhuar pa reflektim tekstin bazë. Ky mungesë personalizimi ngre dyshime serioze mbi aftësinë reale të tij për të ofruar mallrat e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Sipas rregullave të miratuara për paraqitjen e katalogëve:

- Operatorët duhet të dorëzojnë katalogë të përgatitur posaçërisht, që përmbajnë përshkrime teknike të personalizuar.

Kompania merr persiper te prodhoje apo furnizoje mallrat objekt kontrate.

- Katalogu duhet të jetë i firmosur, i vulosur dhe i pajisur me informacion të plotë mbi prodhuesin, furnizuesin, dhe karakteristikat e artikujve.

Në mungesë të këtyre elementeve, dokumenti nuk përmbush standardet minimale për t'u konsideruar katalog i vlefshëm.

Në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik dhe rregulloret në fuqi mbi barazine e operatoreve ekonomik pjesmarres, standardizimin e katalogëve, operatori ekonomik duhet të skualifikohet për shkak se:

- Nuk ka përmbushur kriteret e paraqitjes së dokumenteve (mungesë firme dhe vule).
- Nuk ka ofruar katalog origjinal që dëshmon kapacitet teknik.
- Ka dështuar të personalizojë ofertën sipas kërkesave ligjore dhe teknike.

Në bazë të të gjitha sa më sipër, katalogu i dorëzuar konsiderohet i pavlefshëm dhe i papranueshëm. Operatorit ekonomik i mungon përgjegjësia ligjore, origjinaliteti dhe vërtetësia e dokumentacionit të paraqitur. Për rrjedhojë, ky operator shpallet i skualifikuar nga procedura, në përputhje me parimet e ligjit për prokurimin publik, si dhe me standardet e transparencës, barazise dhe integritetit të procesit të prokurimit.”, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” ShPK për skualifikimin e ofertës së dorëzuar prej tij me pretendimin, si në vijim: “Operatori ekonomik “MUÇA” shpk **nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, ku kërkohet**: 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skadat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi të lotit 1. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Në përmbushje të kësaj kërkesë OE “MUÇA” shpk ka deklaruar se nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi por është distributor i autorizuar i prodhuesve “Goldsit Office Furniture” dhe “3A-PROFILE” shpk, si dhe ka ngarkuar disa broshura me logo të operatorëve të deklaruar. Katalogët e paraqitur nuk janë të vulosur apo të nënshkruar nga prodhuesit e deklaruar, çka do të provonte se janë lëshuar prej tyre.

Për më tepër, për artikujt e mëposhtëm:

Dollap metalik me kanata rrëshqitëse strukturë e fortë, hapësirë efikase

Raft metalik për dosje strukturë e qëndrueshme dhe përdorim funksional

Raft metalik arkivimi strukturë e qëndrueshme me sergjenë të rregullueshëm

Kasafortë sekrete strukturë metalike me mbrojtje të lartë dhe hapësirë të organizuar

OE ka deklaruar si prodhues shoqërinë “3A-PROFILE” shpk. Referuar ekstraktit tregtar të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk, me NUIS K71704022V rezulton se kjo shoqëri nuk është prodhuese për artikujt objekt prokurimi. Në vijim objekti i aktivitetit të shoqërisë “3A-PROFILE” shpk marrë nga regjistri tregtar:

- Import-eksport i pjeseve te kembimit per mjete transporti dhe makineri te te gjitha llojeve. Import eksport, tregtim me shumice e pakice i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, profile hekuri, llamarine, hekur, çimento, tulla, etj. Projektimi, ndertimi i veprave civile, industriale, turistike, restaurime, ndertime rrugore, ndertime vepra arti rrugore dhe

hekurudhore, ndertime hidroteknike, punime mbrojtëse e sistemim hidraulik, etj. Import dhe tregti artikuj ushqimor me shumice dhe pakice.

Gjithashtu edhe në Eëbsite e shoqërisë “3A-PROFILE” shpk (<https://ëëë.3a-profile.al/>) nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë artikujt objekt prokurimi. Ndërsa, për sa i përket shoqërisë tjetër të deklaruar si prodhuese “Goldsit Office Furniture”, duke qenë se është shoqëri Turke nuk është e mundur të kontrollohet nëse ka në objektin e saj prodhimin e artikujve objekt prokurimi. Referuar katalogut të artikujve që kjo shoqëri prodhon/tregon, ngarkuar në eëbsite e shoqërisë (<https://ëëë.goldsit.com/en/category/office-furniture>), nuk rezulton që kjo shoqëri të prodhojë disa nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht: → Shtrat vizite për infermerinë – strukturë metalike dhe mbështetje ergonomike → Varëse rrobash metalike – model “koka e priftit” Gjithashtu, edhe për artikujt e tjerë referuar katalogëve online të shoqërisë “Goldsit Office Furniture” rezulton se specifikimet teknike të artikujve në katalogët e publikuar online nuk plotësojnë kërkesat teknike të artikujve të kërkuar. Në konkluzion OE “MUÇA” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik, pasi malli i ofruar nuk plotëson specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatorët ekonomikë ofertues “ERALD” SHPK dhe “MUCA” SHPK kanë dorëzuar përkatësisht dokumentacionin, si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin e emërtuar “KATALOG.pdf”, i cili përmban një dokument me 36 (tridhjet e gjashtë) faqe, i botuar nën autoritetin shoqërisë “ERALD” SHPK me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “1.Nr2/ Recepton ne formë U-je; 2.Nr6/ Dollap metalik me kanata rrëshqitëse; 3.Nr15/ Dollap me dy kanata; 4.Nr21/ Raft metalik për arkivë; 5.Nr22/ Raft metalik për dosje (arshivë); 6.Nr25/ Raft për dosje, material MDF; 7.Nr27/ Raft për dosje (etazher); 8.Nr30/ Raft me çelësa; 9.Nr33/ Raft për bibliotekën; 10.Nr39/ Komodina dyshe (ushtari); 11.Nr40/ Komodinë zyre; 12.Nr50/ Kasaforta sekrete; 13.Nr68/ Shtrat vizite për infermierinë; 14.Nr70/ Karrige statike pa krahë mbështetës; 15.Nr71/ Karrige statike me krahë mbështetës; 16.Nr72/ Karrige jo statike me krahë mbështetës; 17.Nr73/ Karrige për rangun drejtues; 18.Nr74/ Karrige për kabinetet; 19.Nr75/ Kolltuqe komplet (3+2+1); 20.Nr76/ Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh); 21.Nr77/ Poltron pritje njëvendësh (kolltuk 1- vendësh); 22.Nr79/ Poltron rrotullues; 23.Nr92/ Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona; 24.Nr93/ Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona; 25.Nr105/ Tavolinë klase; 26.Nr110/ Tavolinë mence; 27.Nr113/ Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi; 28.Nr115/ Tavolinë zyre; 29.Nr116/ Tavolinë pune; 30.Nr118/ Tavolinë pune e thjeshtë; 31.Nr123/ 30 Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je; 32.Nr125/ Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe; 33.Nr126/ Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël; 34.Nr134/ Tavolinë me palosje; 35.Nr138/ Krevat tek; 36.Nr143/ Varëse rrobash (koke prifti) metalike dhe 37.Nr156/ Ekspozitorë.”.

Operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Dokumentin e emërtuar “7-katalogje.pdf”, i cili përmban një dokument me 39 (tridhjet e nëntë) faqe, ku 4 (katër) faqe janë botuar nën autoritetin shoqërisë “XXX” SHPK me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “DOLLAP METALIK ME KANATA RRËSHQITËSE – STRUKTURË E FORTË, HAPËSIRË EFIKASE; RAFT METALIK PËR DOSJE – STRUKTURË E QËNDRUESHME DHE PËRDORIM FUNKSIONAL; RAFT METALIK ARKIVIMI – STRUKTURË E QËNDRUESHME ME SERGJENË TË RREGULLUESHËM dhe KASAFORTË SEKRETE – STRUKTURË METALIKE ME MBROJTJE TË LARTË DHE HAPËSIRË TË ORGANIZUAR”. ndërkohë që 35 (tridhjet e pesë) faqe janë botuar nën autoritetin shoqërisë “XXX” me logon e saj, ku pasqyrohen specifikimet teknike për artikujt, si në vijim: “RECEPTION MODERN ME SIPËRFAQE MELAMINE DHE QELQ TË TEMPERUAR; DOLLAP DOKUMENTESH ME KANATE – STRUKTURË MELAMINE DHE PËRFUNDIME CILËSORE; DOLLAP ELEGANT ME RAFTE MDF DHE KANATA XHAMI – FINITURË NATYRALE DHE DIZAJN PREMIUM; DOLLAP ME STRUKTURË MELAMINE – DIZAJN FUNKSIONAL DHE REZISTENCË E LARTË; RAFT PËR ÇELËSA ME DIZAJN ELEGANT DHE MBROJTJE ME KANATA XHAMI – RIMESO ANIGRE DHE STRUKTURË MDF; LIBRARI E LARTË ME STRUKTURË DRURI MULTISTRAT – DIZAJN FUNKSIONAL DHE PËRFUNDIM NATYRAL; KOMODINË FUNKSIONALE ME STRUKTURË MELAMINE – DIZAJN MODERN DHE REZISTENCË E LARTË; KOMODINË ZYRE – STRUKTURË MELAMINE ME PËRFUNDIME CILËSORE; SHTRAT VIZITE PËR INFERMERINË – STRUKTURË METALIKE DHE MBËSHTETJE ERGONOMIKE; KARRIGE STATIKE PA KRAHË – STRUKTURË METALIKE DHE TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KARRIGE STATIKE ME KRAHË MBËSHTETËS – STRUKTURË METALIKE DHE TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KARRIGE ZYRE RROTULLUESE ME KRAHË MBËSHTETËS – ERGONOMI, LËVIZSHMËRI DHE KOMFORT; KARRIGE DREJTUESI – LËKURË ORIGJINALE DHE KOMODITET ERGONOMIK PREMIUM; KARRIGE PËR KABINETE – STRUKTURË DRURI AHU DHE TAPICERI ERGONOMIKE; KOLLUTQJE KOMPLET (3+2+1); KOLLTUK PRITJE DYVENDËSH – DIZAJN MODERN ME TAPICERI LËKURE EKOLOGJIKE; KOLLTUK PRITJE NJËVENDËSH – STIL MODERN DHE KOMODITET ELEGANT; POLTRON RROTULLUES – ERGONOMI AVANCUAR DHE MEKANIZËM SINKRON; TAVOLINË MBLEDHJE DREJTUESI PËR 12 PERSONA – STRUKTURË MDF & KËMBË INOX; TAVOLINË MBLEDHJE DREJTUESI PËR 6 PERSONA – MDF PREMIUM DHE KËMBË INOKSI; TAVOLINË KLASË – STRUKTURË METALIKE DHE SYPRINË MELAMINE REZISTENTE; TAVOLINË MENCE – STRUKTURË METALIKE DHE SYPRINË MELAMINE REZISTENTE; TAVOLINË E VOGËL MESI – PËR ZYRA DREJTUESE STRUKTURË KROM & SYPRINË MDF; TAVOLINË ZYRE ME HARK LIDHËS DHE KOMODINË – STRUKTURË MELAMINE DHE DIZAJN FUNKSIONAL; TAVOLINË PUNE – STRUKTURË MELAMINE 32 MM DHE KANAL KABLLOR INTEGRUAR; TAVOLINË PUNE E THJESHTË – DIZAJN PRAKTIK ME ELEMENTË FUNKSIONALE; TAVOLINË PUNE NË FORMË L-JE – ZGJIDHJE ERGONOMIKE DHE FUNKSIONALE PËR AMBIENTE ZYRE; TAVOLINË DREJTUESI NË FORMË L-JE – MODUL I ZGJERUAR ME TAVOLINË MBLEDHJEJE; TAVOLINË DREJTUESI NË FORMË L-JE – MODUL I VOGËL; TAVOLINË ME PALOSJE – FUNKSIONALE DHE E LËVIZSHME; KREVAT TEK – STRUKTURË E FORTË DHE REHATI MAKSIMALE; VARËSE RROBSH METALIKE – MODEL “KOKA E PRIFTIT” dhe EKSPOZITOR DY-PANELESH ME XHEPA HORIZONTALE.”.

II.4. Të shfuqizojë pikën III.1.10.3., të seksionit “Rrethanat e çështjes”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

III.1.10.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimi të ofertës së tij, të dhënë më datë 25.08.2025 nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përsa i përket mospërmbushjes së kriterit kualifikues të përcaktuar në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku përcaktohet detyrimi që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin skedat teknike apo katalogët për secilin prej produkteve objekt prokurimi të ofruara, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimi nuk lidhet qëllimin e vendosjes së këtij kriteri kualifikues, por me konstatimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përsa i përket vërtetësisë së skedave teknike të paraqitura nga ky operator ekonomik ofertues.

Për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues “KLAME” SHPK ka dorëzuar skedat teknike të produkteve të ofruara (të përmendura në pikën III.1.4. të këtij vendimi), sikurse përcaktohet në këtë kriter kualifikues, ku pasqyrohen specifikimet teknike të këtyre produkteve, ndërkohë që referuar arsyes së skualifikimit të sipërpërmendur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka gjykuar se ky dokumentacion nuk është autentik i prodhuesit të produkteve të ofruara, duke mos i shqyrtuar skedat teknike të dorëzuara nga ofertuesi në raport me vetë qëllimin e vendosjes së këtij kriteri kualifikues dhe konkretisht lidhur me përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ngrihen pretendime lidhur me mospërmbushjen e specifikimeve teknike.

Për më tepër, Komisioni konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në vlerësimin e këtij dokumentacioni të dorëzuar nga ana e ankimuesit nuk i është referuar përcaktimeve të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përsa i përket verifikimeve lidhur me autencitetin e këtyre dokumentave.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar skedat teknike për produktet e ofruara, ku pasqyrohen të gjitha specifikimet teknike të këtyre produkteve, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nëpërmjet këtyre dokumentave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka patur mundësinë për verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga ky operator ekonomik ofertues krahasuar me specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga ana e entit prokurues në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ofertues “KLAME” SHPK qëndron.

BËHET:

Shfuqizohet pika III.1.10.3., të seksionit “Rrethanat e çështjes”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025

II.5. Të shfuqizojë pikën III.3., pikën III.4., pikën III.5, pikën III.6. deri në pikën III.6.9, pikën III.7. deri në pikën III.7.14 dhe pikën III.8. deri në pikën III.8.3., në seksionin “Arsyeton” , të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “MUCA” SHPK, si në vijim: “Kërkojmë lënien e skualifikuar të shoqërisë “MUCA” Sh.p.k, për arsyet që ka publikuar autoriteti në njoftimin e shpalljes së fituesit paraprak si në vijim: ... ”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, ky pretendim është gjykuar më sipër në pikën III.1.10.2., e rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “ERALD” SHPK, si në vijim: “Kërkojmë lënien e skualifikuar të shoqërisë “ERALD” Sh.p.k, për arsyet që ka publikuar autoriteti në njoftimin e shpalljes së fituesit paraprak si në vijim: ... ”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, ky pretendim është gjykuar më sipër në pikën III.1.10.1., e rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për mbetjen të skualifikuar të shoqërisë “EMKO” SHPK, si në vijim: “Kërkojmë lënien e skualifikuar të shoqërisë “EMKO” Sh.p.k, për arsyet që ka publikuar autoriteti në njoftimin e shpalljes së fituesit paraprak si në vijim: ... ”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 25.08.2025, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik KLAME” SHPK mbi shoqërinë “EMKO” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “ERALD” SHPK, si në vijim: “Së dyti, kërkojmë ti shtohen arsyet e skualifikimit operatorit ekonomik, pasi nuk ka plotësuar si duhet nga ligji, pasi nuk ka deklaruar adresën ose dokumentin në Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT dhe D: DEKLARATA Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës në Shtojcën 9 Formulari Përmbledhës për gjithë seksionet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” dhe pika 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT
OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.6.2. Në shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë e dokumentave të tenderit, në Pjesa II: “Shkaqet e përjashtimit”, Seksioni A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe Seksioni D: “DEKLARATA” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</p>

<hr/>
<p><i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i></p> <hr/>
<p><i>etj.</i></p> <p><i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p><i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

<i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

<i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i>				
<i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i>				
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____				

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</i> • <i>Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</i> • <i>Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.6.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kriterëve kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” dhe pika 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK në fazën e ofertimit ka paraqitur në në dokumentacionin e ofertës përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

Shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “ERALD” SHPK, ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, Seksioni A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe Seksioni D: “DEKLARATA” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv”.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (https://qkb.gov.al/ dhe https://e-albania.al/ me dokumentin e Ekstrakt të Rregjistrit Tregtar dhe Vërtetim për Statusin Aktiv)</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k nuk është i dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose të jetë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së”.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (https://e-albania.al/ me dokumentin e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Sektori i Gjendjes Gjyqësore-Vërtetim për gjendjen Gjyqësore të Subjektit</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

1. XXX XXX, DATËLINDJA XX.XX.XXXX, ATËSIA: XXX, MËMËSIA: XXX, VENDLINDJA: XXX, NR. LETËRNJOFTIMI XXX DHE NR. PERSONAL: XXX, NË CILËSINË E ADMINISTRATORIT DHE ORTAKUT TË VETËM.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://e-albania.al/> me dokumentin e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Spektori i Gjendjes Gjyqësore-Vërtetim që personi nuk është i dënuar)

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://e-albania.al/> me dokumentin e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Spektori i Gjendjes Gjyqësore-Vërtetim për Gjendjen Gjyqësore të Subjektit)

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://qkb.gov.al/> dhe <https://e-albania.al/> me dokumentin e Ekstrakt të Regjistrit Tregtar dhe Vërtetim për Statusin Aktiv)

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (Shoqëria “Erald” sh.p.k, ka paguar rregullisht detyrimet për shlyerjen e energjisë elektrike. E provojmë nëpërmjet Vërtetimit për Shlyerjen e Debisë, të lëshuar nga FSHU nga <https://e-albania.al/>)

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://e-albania.al/> me dokumentin lëshuar Nga **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË/DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE/DREJTORIA RAJONALE TATIMORE DURRËS-Vërtetim për Pagim**

Detyrimesh)

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k nuk ka shfaqur asnjë mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (APP nëpërmjet <https://e-albania.al/> dhe nga verifikimet që mund të bëhen në faqen zyrtare të App-së në <https://ëëë.app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik>)

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://qkb.gov.al/dhe> <https://e-albania.al/> me dokumentin e Ekstraktit të thjeshtë të Regjistrit të Pronarit përfitues)

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://qkb.gov.al/dhe> <https://ëëë.tatime.gov.al/> me dokumentin e listëpagesave përkatëse për çdo muaj, Vërtetim për Pagimin e sigurimeve dhe Vërtetim për Pagim Detyrimesh)

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (Vërtetim mospërjashtimi lëshuar nga Agjencia e

Prokurimit Publik (APP nëpërmjet <https://e-albania.al/> dhe nga verifikimet që mund të bëhen në faqen zyrtare të App-së në <https://ëëë.app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik> dhe në listën e subjekteve të përjashtuar)

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (<https://qkb.gov.al/>dhe <https://ëëë.tatime.gov.al/> me dokumentin, Vërtetim për Pagim Detyrimesh), Vërtetim për Gjendjen Gjyqësore të Subjektit, Leje Mjedisore për ushtrim të aktivitetit, Vërtetim për gjendjen Gjyqësore të subjektit).

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none">• Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.• Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.• Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (https://inspektoriatipunes.gov.al/ në rast se na kërkohet nga AK).

III.6.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.6.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.6. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim. 8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

III.6.7. Në pikat 1 dhe 2, të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një

formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.6.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.6.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin konkret Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur Shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETDEKLARIMIT” të cilin e ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, pjesë përbërëse e dokumentacionit të ofertës të dorëzuar prej tij. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK, si dhe nga përmbajtja e këtij formulari, Komisioni konstaton se shoqëria “ERALD” SHPK ka plotësuar në mënyrë të saktë secilën prej rubrikave të përcaktuara në seksionin A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, duke deklaruar në mënyrë të saktë çdo dokument që do të dorëzohet në përmblyshje të rubrikave të kësaj deklaratë dhe institucionin që do të lëshojë dokumentin përkatës, SI DHE ka plotësuar në mënyrë të saktë secilën prej rubrikave të përcaktuara në Seksionin D: “DEKLARATA”, duke bërë deklaratimet e kërkuara dhe duke deklaruar institucionin që vërteton se shoqëria “ERALD” SHPK nuk ka masë ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH).

Komisioni gjykon se operatori ekonomik “ERALD” SHPK e ka plotësuar seksionin A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe Seksionin D: “DEKLARATA” të Shtojcës 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETDEKLARIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi në mënyrë të saktë, duke përmbushur kriteret kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” dhe pika 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, duke dhënë të dhëna që ky formular parashikon.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “ERALD” SHPK, si në vijim: “Së fundmi, nga verifikimi i arsyeve të skualifikimit kemi parë që operatori ka paraqitur katalog si prodhues i të gjithë mallrave, ndërkohë, pasi verifikuam në QKb objektin e veprimtarisë së këtij operatori rezultoi mospërputhje thelbësore: objekti i veprimtarisë së “ERALD” sh.p.k. parashikon tregtim të pajisjeve të sigurisë, ndërsa në katalog operatori paraqitet si prodhues i kasafortave. Kjo çënon autenticitetin dhe besueshmërinë e dokumentacionit teknik. Këto mangësi janë substanciale dhe nuk mund të rregullohen pas afatit të hapjes së ofertave pa çënuar parimin e trajtimit të barabartë, prandaj skualifikimi duhet të mbetet në fuqi dhe ti shtohet edhe kjo arsye.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në Seksionin 2 “Objekti i kontratës” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar objektin e prokurimit dhe kodet sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit, si më poshtë vijon:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”

Loti 1: "Blerje orendish për mobilim"

Loti 2: "Blerje pajisjesh"

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-52889-06-30-2025

LOTI 1: REF-52892-06-30-2025

LOTI 2: REF-52895-06-30-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 39150000-8; 39711130-9; 32324100-1

39150000-8; Mobilje dhe pajisje të ndryshme

39711130-9; Frigoriferë

32324100-1 Televizor me ngjyra

III.7.2. Në Shtojcën 7 "FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT", të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar artikujt objekt prokurimi për Lotin 1, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

LOTI 1 "BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM"

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Nr. Katalogu OBP	Emërtimi i artikujve	Njësia matëse	Sasia	Periudha e dorëzimit
1	2	Reception në formë U-je	Copë	1	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
2	6	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
3	15	Dollap me dy kanata rrobash për zyra	Copë	51	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
4	21	Raft metalik për arkivë	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
5	22	Raft metalik për dosje (arshivë)	Copë	47	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
6	25	Raft për dosje, material MDF	Copë	122	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
7	27	Raft për dosje (etazher)	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
8	30	Raft me çelësa	Copë	10	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
9	33	Raft për bibliotekën	Copë	20	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës

10	39	Komodina dyshe (ushtari)	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
11	40	Komodinë zyre	Copë	60	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
12	50	Kasaforta sekrete	Copë	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
13	68	Shtrat vizite për infermierinë	Copë	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
14	70	Karrige statike pa krahë mbështetës	Copë	65	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
15	71	Karrige statike me krahë mbështetës	Copë	45	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
16	72	Karrige jo statike me krahë mbështetës	Copë	50	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
17	73	Karrige për rangun drejtues	Copë	20	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
18	74	Karrige për kabinetet të thjeshta	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
19	75	Kolltuqe komplet (3+2+1)	Komplet	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
20	76	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
21	77	Poltron pritje njëvendësh (kolltuk1-vendësh)	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
22	79	Poltron rrotullues	Copë	63	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
23	92	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
24	93	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
25	105	Tavolinë klase	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
26	110	Tavolinë mence	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
27	113	Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
28	115	Tavolinë zyre	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
29	116	Tavolinë pune	Copë	59	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
30	118	Tavolinë pune e thjeshtë (Instruktori)	Copë	7	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
31	123	Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je	Copë	22	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
32	125	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
33	126	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël	Copë	11	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
34	134	Tavolinë me palosje	Copë	15	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
35	138	Krevat Tek	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
36	143	Varëse rrobash (koke prifti) metalike	Copë	60	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës

37	156	Ekspozitorë	Copë	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
----	-----	-------------	------	---	--

III.7.3. Në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 1/a “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” dhe pika 1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.7.4. Në shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” pjesë e dokumentave të tenderit, në Pjesa II: “Shkaqet e përjashtimit”, Seksioni A: “DEKLARATA

PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<u>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</u>
<u>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</u>

III.7.5. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në Shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 1/a “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK në fazën e ofertimit ka paraqitur në dokumentacionin e ofertës përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

Shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “ERALD” SHPK, ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, Seksioni A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” dhe Seksioni D: “DEKLARATA” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<u>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</u>
Po, “Operatori ekonomik “ERALD” sh.p.k është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv”.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (https://qkb.gov.al/ dhe https://e-albania.al/ me dokumentin e Ekstrakt të Rregjistrit Tregtar dhe Vërtetim për Statusin Aktiv)

III.7.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.7.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.7.8. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. “.

III.7.9. Në pikat 1 dhe 2, të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në

deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.7.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.7.11. Në Shtojcën 1 “Lista e kodeve CPV” të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 30.07.2021 “PËR MIRATIMIN E FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT” parashikohet shprehimisht se:

Shtojca1:

Fjalori i përbashkët i prokurimit
Lista e kodeve CPV

Shpjegime dhe përshkrime:

Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi.

Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik, një prej kodeve të përcaktuara, që i korrespondon objektit konkret të prokurimit.

Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndarë si më poshtë:

- dy shifrat e para identifikojnë ndarjet (XX000000-Y),
- tre shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y),
- katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y),
- pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y).

Secila prej tre shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme.

KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

32324100-1; Televizor me ngjyra

39150000-8; Mobilje dhe pajisje të ndryshme

39711130-9; Frigoriferë

III.7.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë

vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.7.13. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.7.14. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK, për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë “ERALD” SHPK, gjykojmë se kriteri në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues, në përputhje me objektin e procedurës objekt ankimi, është një kërkesë e cila bën pjesë tek kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku referuar përcaktimeve në dokumentet e tenderit këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Shtojcës 9 “FORMULARIT PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT” të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK rezulton se për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur Shtojcës 9 “FORMULARIT PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT”.

Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrat Tregtar për të dhënat e subjektit “ERALD” SHPK, i publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se objekti i

aktivitetit të shoqërisë “ERALD” SHPK është përcaktuar: **“Prodhim dhe tregtim, mobilje të ndryshme, me bazë druri dhe materialeve ndihmëse, prej metali, kombinime dru metal, dyer, dritare prej druri dhe metali, plastikë, veshje, konfeksione, elektroshtepiake, bujqësore, blegtorale, ushqimore, materiale ndërtimi, lëndë drusore, hidrosanitare, përpunim të lëndëve drusore si mobilieri, të të gjitha llojeve për objekte banimi, objekte publike, të sistemit shkollor, administrativ, shëndetsor, punime artistike, makineri dhe pjesë kembimi, vegla auto, pjesëve të këmbimit për automjete dhe makineri, bimëve mjekësore, materialeve elektrike, hidrosanitare, vegla dhe paisje të ndryshme pune, materialeve elektronike, servis, parking, transport te mallrave dhe të udhëtareve, argjendari, tregtim argjendari, bizhuteri, kozmetike, fruta zezave, plehra kimike, agjensi transporti, taksi, turizëm, prodhime druri, përpunim të drurit si dhe tregtim te artikujve te prodhuar me dru dhe materiale ndihmëse të drurit, përpunim te metalit, tregtim te artikujve te prodhuara prej metali dhe grumbullim e përpunim të hekurishteve, transport per vehte dhe te tretë. Importimin dhe tregtimin e linjave teknologjike për industrinë ushqimore, të 2 përpunimit të materialeve drusore dhe ato të hidrokarbureve, të përpunimit të lëkurës dhe veshmbathjeve, të aparaturave në fushën e shëndetit dhe trajtimit të medikamenteve mjekësore. Importimin dhe tregtimin e materialeve për përdorim mjekësor si dhe të paisjeve dhe aparaturave për të njëjtin qëllim. Prodhim dyshekësh të përmasave të ndryshme dhe pjesëve ne shërbim te tyre, materiale të imta (çarçafë, batanije, jastëk, rroba pune), rrobaqepësi dhe paisje te tjera te lidhura me to, tregtim me shumicë dhe pakicë të tyre, import-export. Ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushën e teknologjisë së informacionit: institucioneve publike dhe private, organizatave, SME-ve. Aktivitet në fushën e turizmit, hapje hotelesh, bar-kafe, restorante etj. Shërbim në fushën publike. Shërbime të ndryshme komunale, publike, riparim objektesh dhe shërbime menaxhimi në fushën e shërbimeve publike. Tregtim të paisjeve dhe materialeve të ndryshme të sigurisë personale dhe kolektive”.**

Gjithashtu referuar dokumentave standarte të tenderit konkretisht seksionit 2 “Objekti Kontratës” pika 2.2 “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)”, rezulton se autoriteti kontraktor për Lotin 1 ka përcaktuar kodin, si në vijim: “39150000-8; Mobilje dhe pajisje të ndryshme”, ndërkohë referuar Shtojcës 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit janë mobilje druri dhe mobilje prej metali, ndërkohë që referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “ERALD” SHPK, i publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit Komisioni konstaton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “ERALD” SHPK përfshin objektin e prokurimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në objektin e veprimtarisë ka të përcaktuar se përfshin dhe aktivitetin profesionalsi në vijim: **“Prodhim dhe tregtim, mobilje të ndryshme, me bazë druri dhe materialeve ndihmëse, prej metali, kombinime dru metal,”.**

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Shtojca 9 “FORMULARIT PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT”, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “ERALD” SHPK, sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar si më sipër cituar rezulton se përfshihet objekti i prokurimit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.8.1. Parashikimi i nenit 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.8.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.8.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi, është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën.

Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë trajtuara në pikën III.6 dhe pikën III.7 të këtij vendimi, si dhe referuar pikës III.1.10.1. të këtij vendimi ka ndryshuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 25.08.2025, duke e ndryshuar gjendjen juridike faktike të operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, i cili do të kualifikohet, ndaj pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertës së operatorit tjetër pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, në rastin konkret për operatorin ekonomik “MUCA” SHPK nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

BËHET:

Shqfuqizohet pika III.3., në seksionin “Arsyeton”

Shqfuqizohet pika III.4., në seksionin “Arsyeton”

Shqfuqizohet pika III.5., në seksionin “Arsyeton”

Shqfuqizohet pika III.6. deri në pikën III.6.9. në seksionin “Arsyeton”

Shqfuqizohet pika III.7. deri në pikën III.7.14. në seksionin “Arsyeton”

Shqfuqizohet pika III.8. deri në pikën III.8.3. në seksionin “Arsyeton”

II.6. Të shtojë pikën III.3. në seksionin “Arsyeton”, të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

III.3. Lidhur me ankesën e adiministruar në datën 10.09.2025 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK, me numër ankimi elektronik nr. A/2025/5795, datë 10.09.2025 dhe me numër protokolli nr. 2446/2025 prot, datë 10.09.2025, në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK, nga procedura e prokurimit e sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

- “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*
- 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*
- 3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*
- 4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.3.1. Në gjermën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.3.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2034/18 prot, datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2446/3 prot, datë 18.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 90/2025”, datë 16.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ ...

II.1. Në datën 09.09.2025, Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokollit 2446/2025, datë 09.09.2025 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2025/5795, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaqme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e 68 ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE” nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datë 12.09.2025 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën si dhe me vetë formularin e ankesës.

Plotësimi i këtyre mangësive nuk u korrigjua brenda dy ditëve nga njoftimi.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankimim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se përderisa operatori ekonomik ankimues “KLAME” shpk nuk ka arritur që brenda afatit 2 ditor, të plotësojë mangësitë e konstatuara lidhur me elementët përmbajtësorë të ankesës, kjo e fundit konsiderohet si e pa paraqitur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.

III.3.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht

pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr 2034/18 prot., datë 17.09.2025 me objekt "Vendim KSHA 90/2025" protokolluar me tonën me numër nr. 2446/3 prot, datë 18.09.2025 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes sistemit elektronik të ankesave i ka kërkuar operatorit ekonomik "KLAME" SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke i kërkuar si në vijim: "... Lutemi për plotësimin e mangësisë së konstatuar mbi pagesën e diferencës së vlerës të mandatit lidhur me ankesën e sipërpërmendur. Në rast se korrigjimet e mësipërme nuk do të bëhen Brenda dy ditëve, ankesa me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5795 do të vlerësohet sii e pa paraqitur. ..."

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të

dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 12.09.2025) operatorin ekonomik ankimes përmes sistemit elektronik të ankesave, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së plotë të ankesës, ndërkohë që nga verifikimet në sistemin e ankesave

elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës.

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën e plotë financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

II.7. Të ndryshojë dispozitivin në seksionin “Vendos” , të vendimit Nr.1488/2025, datë 21.10.2025, si më poshtë:

ISHTE:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*
- 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*

3. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*
 4. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.*
 5. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.*
 6. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.*
 7. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
 8. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK.*
 9. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK.*
 10. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.*
 11. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 12. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

BËHET:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025”, me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: “Blerje orendish për mobilim”, me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.

5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "MUCA" SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.
6. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
7. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ERALD" SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "MUCA" SHPK.
9. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të pjesës së tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes "KLAME" SHPK.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.23. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 1857/2025, datë 15.12.2025, vendosi:

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-52889-06-30-2025, me objekt: "Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025", me fond limit 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: REF-52892-06-30-2025, me objekt: "Blerje orendish për mobilim", me fond limit të lotit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.23. Në përfundim të procesit të riverësimit të procedurës së prokurimit, më datë 14.01.2026, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	“MUCA” sh.p.k	17,710,500	leke	skualifikuar
2	“ERALD” sh.p.k	21,316,800	leke	skualifikuar
3	“E M K O ” sh.p.k	21,595,000	leke	skualifikuar
4	“KLAME” sh.p.k	21,981,500	leke	skualifikuar
5	“URBAN FURNITURE” sh.p.k	22,192,800	leke	kualifikuar
6	“BOLT” sh.p.k	25,213,628	leke	skualifikuar
7	“Eduart Xhixha” Person Fizik	25,772,500	leke	kualifikuar
8	“SHAGA.” sh.p.k	31,263,015	leke	kualifikuar
9	“ERZENI/SH” sh.p.k	31,572,670	leke	skualifikuar
10	“Alpha Furniture” sh.p.k	33,131,984	leke	skualifikuar

II.24. Në datën 14.01.2026, operatori ekonomik “MUCA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“ 1. Operatori ekonomik “Muca” sh.p.k., me Nipt K01421002H, pas verifikimit të dokumentacionit fizik të paraqitur, rezulton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për arsytet si më poshtë:

➤ Nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, piken 2.3.2 , nenpiken ku kërkohej që OE duhet të ketë punonjes me kualifikimet “2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh” të vertetuar me “kontratën individuale të punës” dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Konkretisht OE në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur kontratat e punës për punonjesit Ervis Sorra dhe Dhimitri Miti të cilët janë të punësuar si marangoz pranë kesaj shoqërie. Gjate shqyrtimit të dokumentacionit fizik KVO konstaton:

- Per punonjesin E. S. me pozicion pune Marangoz ka paraqitur Certificate mbi përfundimin e kursit të formimit profesional “Marangoz dhe Mobilier” të lëshuar nga qendra e formimit profesional “Agjencia Shqiptare e Punesimit” me Nipt L21410066G. Nga verifikimi i kryer në QKB konstatohet që subjekti që ka lëshuar dëshminë e nivelit të kualifikimit arsimor “Agjencia Shqiptare e Punesimit” me Nipt L21410066G në listën e kurseve profesionale për të cilat është e licensuar nuk ka të përfshirë kurse për “marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh”.
- Ndersa për punonjesin tjetër Dh. M. me pozicion pune Marangoz OE nuk ka paraqitur diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik, teknik dhe përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me ofertën e paraqitur, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 31, 40, 82 të tij, vendosi të skualifikojë operatorin ekonomik “Muca” sh.p.k., me Nipt K01421002H, për shkak se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”.

II.25. Në datën 14.01.2026, operatori ekonomik “ERALD” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Erald” sh.p.k, NUIS J74517205P për procedurën e prokurimit me objekt: Loti I: “Blerje orendish për mobilim”, rezultoi se:

- Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k, NUIS J74517205P, me dokumentacionin e paraqitur nuk ka arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, për arsyet si më poshtë:
- 1. OE nuk ka argumentuar / provuar me dokumente shkresore, plotesimin e pikave b,c, ç të parashikuara në nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” pika 2 ku ndër të tjera përcaktohet se:

“Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht” për:

- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Theksojme që, referuar edhe vendimarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik, barra e provës referuar nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët dhe OE ka detyrimin të plotësojë katër kushtet kumulative për të dhënë bindje dhe garanci AK që kontrata do të përmbushet me sukses. Eshte detyrë e OE të paraqesë para autoritetit kontraktor:

- zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës, sipas pikës 2.b Neni 93 i LPP.

- *prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi sipas pikes 2.c Neni 93 i LPP.*
- *Të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi sipas pikes 2. ç Neni 93 i LPP.*

Sa me sipër cituam operatori ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk ka arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht, KVO konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Erald” sh.p.k., NUIS J74517205P, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori skualifikohet.”.

II.26. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 15.01.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “*URBAN FURNITURE*” SHPK.

II.27. Në datën 21.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6264, datë 21.01.2026 dhe numër protokoll nr. 173/2026, datë 21.01.2026 e operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*MUCA*” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.28. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 173/1, datë 22.01.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.29 . Me shkresën nr. 2034/22 prot, datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2418/2 prot, datë 22.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 93/2025*”, datë 19.09.2025, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.30. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*URBAN FURNITURE*” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i

interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 173/2 prot., datë 26.01.2026.

II.31. Në datë 29.01.2023, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 3817/11 prot, datë 29.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 173/3 prot, datë 29.01.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 12/2026”, datë 29.01.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.31 . Me shkresën nr. 3817/12 prot, datë 29.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 173/4 prot, datë 30.01.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 12/2026”, datë 29.01.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.32. Në datën 26.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6276, datë 26.01.2026 dhe numër protokoll nr. 227/2026, datë 26.01.2026 e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.33. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 227/1, datë 27.01.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ERALD” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.34. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “URBAN FURNITURE” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 227/2 prot., datë 02.02.2026.

II.35. Në datë 09.02.2023, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 3817/15 prot, datë 06.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 227/3 prot, datë 09.02.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 18/2026”, datë 06.02.2026,

për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ERALD” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.36. Me shkresën nr. 3817/16 prot, datë 06.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 227/4 prot, datë 09.02.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 18/2026”, datë 06.02.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ERALD” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.37. Me shkresën nr. 227/5 prot., datë 25.02.2026 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të dërgojë dokumentacionin e dorëzuar në datë 08.01.2026 nga operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A, për argumentimin e ofertës së tij ekonomikesipas përcaktimeve të nenit 93 të të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II.38. Me shkresën nr. 227/6 prot., datë 06.03.2026 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka rikërkuar nga autoriteti kontraktor që të dërgojë dokumentacionin e dorëzuar në datë 08.01.2026 nga operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A, për argumentimin e ofertës së tij ekonomikesipas përcaktimeve të nenit 93 të të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II.39. Me shkresën nr. 3817/18 prot, datë 06.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 227/7 prot, datë 09.03.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacionin i dorëzuar në datë 08.01.2026 nga operatori ekonomik ofertues “ERALD” SHPK pranë autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A, për argumentimin e ofertës së tij ekonomikesipas përcaktimeve të nenit 93 të të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave në datën 14.01.2026, me arsyetimin si në vijim: “1. Operatori ekonomik “Muca” sh.p.k., me Nipt

K01421002H, pas verifikimit të dokumentacionit fizik të paraqitur, rezulton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit per arsyet si me poshte:

➤ Nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, piken 2.3.2 , nenpiken ku kerkohet qe OE duhet te kete punonjes me kualifikimet “2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh” te vertetuar me “kontratën individuale të punës” dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Konkretisht OE ne permbushje te këtij kriteri ka paraqitur kontratat e punes per punonjesit Ervis Sorra dhe Dhimitri Miti te cilet jane te punesuar si marangoz prane kesaj shoqerie. Gjate shqyrtimit te dokumentacionit fizik KVO konstaton:

- Per punonjesin E. S. me pozicion pune Marangoz ka paraqitur Certificate mbi perfundimin e kursit të formimit profesional “Marangoz dhe Mobilier” te leshuar nga qendra e formimit profesional “Agjencia Shqiptare e Punesimit” me Nipt L21410066G. Nga verifikimi i kryer ne OKB konstatohet qe subjekti qe ka leshuar deshmine e nivelit te kualifikimit arsimor “Agjencia Shqiptare e Punesimit” me Nipt L21410066G ne listen e kurseve profesionale per te cilat eshte e licensuar nuk ka të përfshirë kurse per “marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh”.
- Ndersa per punonjesin tjetër Dh. M. me pozicion pune Marangoz OE nuk ka paraqitur diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik, teknik dhe përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me ofertën e paraqitur, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), neni 80, 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 31, 40, 82 të tij, vendosi të skualifikojë operatorin ekonomik “Muca” sh.p.k., me Nipt K01421002H, për shkak se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 8 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” pika 2.3.2 “**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë të kualifikimit, si më poshtë vijon:

“2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri, në rast se është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (një) Bojaxhi/llustrues për prodhime druri, nëse është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.

- leje drejtimi, e vlefshme;

2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi. Për punonjësit që janë kërkuar edhe me kontraktim të paraqitet kontrata përkatëse.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.”.

III.1.2. Në shtojcën 9 “**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**” pjesë e dokumentave të tenderit, në Pjesa III: “**Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit**”, Seksioni B: “**DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’**” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta</i>	<u><i>Punonjës</i></u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i> <hr/> <i>Profili i punonjësve</i> <hr/> <hr/>

<p><i>paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p>	<p><u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuara në Shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.3.2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “*MUCA*” SHPK në fazën e ofertimit ka paraqitur në në dokumentacionin e ofertës përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

Shtojcën 9 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “*MUCA*” SHPK, ku në Pjesën III: “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*”, Seksioni B: “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’*” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] numri i punonjësve: rreth 58 punonjës me kontrata</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve: 1 ndryshëm, përfshirë me shume se 1 shofer, shitësa, dhe montues, te, arkitektë, më shumë se 1 marangoz dhe më shumë se 2 punonjës të thjeshtë ngarkim shkarkimi, etj. Në rast të shpalljes fitues dhe/ose nëse kërkohet nga AK, mund tia vëmë në dispozicion vërtetim për nr e punonjësve listëpagesat dhe dokumentat përkatëse për të paktën 9 nga punonjësit tanë përfshirë ata të deklaruar më lart.</p> <p><u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []</p>

	<p>Shoqëria MUCA disponon më shumë se 1 mjet transporti, me dokumentacion të rregullt, NË PRONËSI për transportin e mallrave ndër ta edhe Mjetin me targe AAI40CT.</p> <p>Në rast të shpalljes fitues dhe/ose nëse kërkohen nga AK, mund tia vëmë në dispozicion dokumentat përkatëse për mjetet e deklaruar.</p>
<p>MUCA shpk shpk ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vëndet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe këstet e maturuara të vitit 2025, (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr, 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" Indryshuar, neni 5, pika c.</p> <p>Në rast të shpalljes fitues dhe/ose nëse kërkohen nga AK, mund tia vëmë në dispozicion dokumentat përkatëse.</p>	
<p>Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër</p>	
<p>Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direksi këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.</p>	
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Deklaratë e lëshuar nga administratori i shoqërisë “MUCA” SHPK me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“ **DEKLARATË SHITESË 3**

Unë i nënshkuari Genci MUÇA, me cilësinë e Administratorit të personit juridik MUÇA shpk me NIPT K01421002H, pjesëmarrës në tenderin që organizon: AK - Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me objekt: "Loti 1: "Blerje orendish për mobilim", me REF-52892-06-30-2025.

Deklaroj:

Muca sh.p.k nuk është prodhues i mobiljeve dhe produkteve metalikeve, por është distributor i autorizuar i prodhuesve Goldsit Office Furniture dhe 3A Profile sh.p.k.”.

III.1.4. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “MUCA” SHPK më datë 29.12.2025 pranë autoritetit kontraktor dhe të dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën nr. 3817/12 prot, datë 29.01.2026, protokolluar me tonën me nr.

173/4 prot, datë 30.01.2026, konstatohet se operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK për vërtetimin e deklarimeve të bëra në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” të Shtojcës 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “MUCA” SHPK dhe për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional” të shtojcës 7 “FORMULAR II KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke paraqitur dokumentacionin, si më poshtë vijon:

1. Kontratë pune datë 01.10.2020, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Endro Çuka**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Menaxher blerje**”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
2. Kontratë pune datë 01.04.2007, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Ylli Muja**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Shofer**”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, dhe maj 2025.
3. Kontratë pune datë 27.05.2019, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit znj. **Suada Gjoka**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Shitëse**”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, e cila figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
4. Kontratë pune datë 04.01.2008, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Petrika Jaupi**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Shofer**”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
5. Kontratë pune datë 01.10.2020, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Ervis Sorra**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Marangoz**”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
Certifikatë nr. 2860/K amëz, datë 18.01.2024, e lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional – ASHP, ku vërtetohet se z. **Ervis Sorra** ka përfunduar kursin e formimit profesional “**Marangoz dhe Mobilier**”, e fotokopjuar dhe e noterizuar.

6. Kontratë pune datë 04.04.2016, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Piro Miti**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Magaznier”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
7. Kontratë pune datë 01.12.2023, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Dhimitri Miti**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Punëtor/Marangoz”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i cili figuron në listëpagesën e muajit prill 2025.
8. Kontratë pune datë 01.02.2023, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Erjon Subashi**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Punëtor për sistemin malli”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
9. Kontratë pune datë 01.02.2023, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Ervis Haxhiu**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Punëtor për sistemin malli”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.
10. Kontratë pune datë 05.04.2022, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Nazmi Shehu**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Shofer”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili nuk figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025..
11. Kontratë pune datë 10.08.2020, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Arben Haka**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Shofer”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025..
12. Kontratë pune datë 01.02.2023, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Morin Xhikolli**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “Projektues arkitekt”, për një periudhë kohore “pa afat”, e fotokopjuar dhe e noterizuar, i pajisur me leje drejtimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025.

Diplomë “*Master shkencor në ARKITEKTURË*” nr. 75, datë 18.11.2011, lëshuar nga Universiteti “ALBANIAN UNIVERSITY”, për z. Morin Xhikolli, e fotokopjuar dhe e noterizuar.

13. Kontratë pune datë 01.02.2023, të lidhur midis punëdhënësit “MUCA” SHPK dhe punëmarrësit z. **Juxhin Avdullari**, i cili punësohet pranë punëdhënësit në pozicionin “**Ekonomist**”, për një periudhë kohore “pa afat”, i cili figuron në listëpagesat e muajit prill 2025, maj 2025 dhe qershor 2025..

Certifikatë nr. 000307, datë 01.03.2024, e lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri”, ku vërtetohet se z. **Juxhin Avdullari** ka përfunduar kursin e formimit profesional mbi njohuritë bazë për përgjegjës për sigurinë në punë, në njohjen me rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë, e fotokopjuar dhe e noterizuar.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.7. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk

është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepr

penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim. 8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.”.

III.1.8. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2, të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një

formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.11. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për mallrave”, pika 5 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.13. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues duhet të dëshmojnë se disponojnë në stafin e tyre jo më pak se 7 (shtatë) punonjës në muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, ku referuar datës së hapjes së ofertave e cila është data 31.07.2025, duhet të dëshmojë se disponon në këtë staf për muajin qershor 2025, dëshmuar kjo nëpërmjet paraqitjes së listëpagesave për këtë muaj, ndërkohë që githashtu në përbërjen e këtij stafi duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier druri vërtetuar me diploma dhe kontratë pune (*në rastin kur operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve objekt prokurimi*), duhet të ketë të punësuar 2 (dy) marangozë ose 2 (dy) mobilier ose 2 (dy) montues mobiljesh vërtetuar kjo me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar dhe kontratën e punës, duhet të ketë të punësuar 1 (një) bojaxhi ose 1 (një) ilustrues për prodhime druri vërtetuar kjo me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar dhe kontratën e punës (*në rastin kur operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve objekt prokurimi*), duhet të ketë të punësuar 1 (një) shofer vërtetuar kjo me paraqitjen e lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe kontratën e punës, si dhe duhet të ketë të punësuar 2 (dy) punonjës

të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar kjo me paraqitjen e kontratës së punës.

Sipas parashikimeve të nenit 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, se kriteri kualifikues i sipërpërmendur në fazën e ofertimit do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të shtojcës 9 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” i publikuar në këto dokumentav tenderi, ku në këtë formular ofertuesi duhet të deklarojë disponimin e stafit të kërkuar në këtë kriter kualifikues.

Gjithashtu në shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t’i kërkojë ofertuesit fitues (*ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë*) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, sikurse parashikohet në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

III.1.14. Lidhur me pretendimin e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertve pas fazës së rivlerësimit të procedurës së prokurimit në datën 14.01.2026, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “*MUCA*” SHPK ka dorëzuar dokumentin “*DEKLARATË SHITESË 3*” ku ka deklaruar se nuk është prodhues I produkteve të ofruara prej tij në këtë procedurë prokurimi, si dhe ka dorëzuar Shtojcën 9 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” ku nga deklarimet e bëra rezulton se ka të punësuar 58 (*pesëdhjet e tetë*) punonjës, ku në përbërje të këtij stafi ka më shumë se 1 (një) shofer, se 1 (një) shitës, se 1 (një) montues, se 1 (një) arkitekt, se 1 (një) marangoz dhe më shumë se 2 (dy) punonjës të thjeshtë ngarkim shkkarkimi, duke plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përse i përket fazës së parë të vlerësimit, pasi ofertuesi nuk është deklaruar prodhues I produkteve të ofruara.

Akoma më tej, Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin fizik të dorëzuar në datë 29.12.2025 nga ana e operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK, lidhur me përmbushjen e deklarimeve të bëra prej këtij operatori ekonomik në Shtojcën 9 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” nga ku rezultoi se për muajin qershor 2025 ka të punësuar 58 (*pesëdhjet e tetë*) punonjës, vërtetuar kjo nëpërmjet deklaratave “*Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi*” për muajt qershor 2025, të tatimpaguesit “*MUCA*” SHPK, me nënshkrim elektronik.

Gjithashtu nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni fizik, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK disponon në stafin e tij për muajin qershor 2025, 1 (një) menaxher blerje vërtetuar me kontratë individuale pune, 5 (pesë) shoferë vërtetuar me kontratë individuale pune dhe lejes së drejtimit të automjetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, 2 (dy) punëtorë për sitemimin e mallit vërtetuar me kontratë individuale pune, 1 (një) ekonomist vërtetuar me kontratë individuale pune, 1 (një) shitëse vërtetuar me kontratë individuale pune, 1 (një) marangoz të pajisur me certifikatë të lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku vërtetohet se ka përfunduar kursin “Marangoz dhe Mobilier” dhe vërtetuar me kontratë individuale pune, 1 (një) magazinier vërtetuar me kontratë individuale pune, 1 (një) punëtor/marangoz vërtetuar me kontratë individuale pune dhe 1 (një) projektues/arkitekt vërtetuar me kontratë individuale pune dhe Diplomë “Master shkencor në ARKITEKTURË”.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ofertuesi “MUCA” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi me dokumentacionin e dorëzuar nuk vërteton se për ka të punësuar në stafin e tij 2 (dy) marangozë ose 2 (dy) mobilier ose 2 (dy) montues mobiljesh për muajin qershor 2025, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar prej tij dhe të cituar në pikën III.1.4., të këtij vendimi konstatohet se operatori ekonomik ankimues ka të punësuar në stafin e tij vetëm 1 (një) marangoz të pajisur me certifikatë që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, të lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe të pajisur me kontratë punë, ndërsa për punonjësën z. Dhimitri Miti, i cili referuar kontratës së punës datë 01.12.2023 rezulton i punësuar me profesionin “Punëtor/Marangoz” nuk është paraqitur certifikatë që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, të lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “MUCA” ShPK nuk e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, lidhur me disponimin në stafin e tij të 2 (dy) marangozë ose 2 (dy) mobilier ose 2 (dy) montues mobiljesh për muajin qershor 2025.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ERALD” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave në datën 14.01.2026, me arsyetimin si në vijim:, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se: “Nga

shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Erald" sh.p.k, NUIS J74517205P për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1: "Blerje orendish për mobilim", rezultoi se:

- Operatori ekonomik "Erald" sh.p.k, NUIS J74517205P, me dokumentacionin e paraqitur nuk ka arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, për arsyet si më poshtë:
2. **OE nuk ka argumentuar / provuar me dokumente shkresore, plotesimin e pikave b, c, ç te parashikuara ne nenin 93** "Oferta anomalisht e ulët" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" pika 2 ku ndër të tjera përcaktohet se:

"Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht" për:

- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Theksojme që, referuar edhe vendimarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik, barra e provës referuar nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët dhe OE ka detyrimin të plotësojë katër kushtet kumulative për ti dhënë bindje dhe garanci AK që kontrata do të përmbushet me sukses. Eshte detyrë e OE të paraqesë para autoritetit kontraktor:

- zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës, sipas pikes 2.b Neni 93 i LPP.
- prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi sipas pikes 2.c Neni 93 i LPP.
- Të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi sipas pikes 2. ç Neni 93 i LPP.

Sa me sipër cituam operatori ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk ka arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht, KVO konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues "Erald" sh.p.k., NUIS J74517205P, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori skualifikohet.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 3 “*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar formularin e deklaramit të çmimit të ofruar për produktet objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 3.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t’u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
	Çmimi total (Mallrat)				_____

Çmimi Neto pa TVSH	
TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.2.2. Në Shtojcës 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*”, **LOTI 1 “BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM”** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar listën dhe sasinë e artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

LOTI 1 "BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM"

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Nr. Katalog u OBP	Emërtimi i artikujve	Njësia matëse	Sasia	Periudha e dorëzimit
1	2	Reception në formë U-je	Copë	1	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
2	6	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
3	15	Dollap me dy kanata rrobash për zyra	Copë	51	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
4	21	Raft metalik për arkivë	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të

					kontratës
5	22	Raft metalik për dosje (arshivë)	Copë	47	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
6	25	Raft për dosje, material MDF	Copë	122	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
7	27	Raft për dosje (etazher)	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
8	30	Raft me çelësa	Copë	10	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
9	33	Raft për bibliotekën	Copë	20	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
10	39	Komodina dyshe (ushtari)	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
11	40	Komodinë zyre	Copë	60	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
12	50	Kasaforta sekrete	Copë	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
13	68	Shtrat vizite për infermierinë	Copë	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
14	70	Karrige statike pa krahë mbështetës	Copë	65	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
15	71	Karrige statike me krahë mbështetës	Copë	45	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
16	72	Karrige jo statike me krahë mbështetës	Copë	50	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
17	73	Karrige për rangun drejtues	Copë	20	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
18	74	Karrige për kabinetet të thjeshta	Copë	40	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
19	75	Kolltuqe komplet (3+2+1)	Komplet	3	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
20	76	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës

21	77	Poltron pritje njëvendësh (kolltuk1-vendësh)	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
22	79	Poltron rrotullues	Copë	63	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
23	92	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
24	93	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
25	105	Tavolinë klase	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
26	110	Tavolinë mence	Copë	25	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
27	113	Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi	Copë	5	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
28	115	Tavolinë zyre	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
29	116	Tavolinë pune	Copë	59	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
30	118	Tavolinë pune e thjeshtë (Instruktori)	Copë	7	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
31	123	Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je	Copë	22	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
32	125	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe	Copë	4	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
33	126	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël	Copë	11	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
34	134	Tavolinë me palosje	Copë	15	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
35	138	Krevat Tek	Copë	30	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
36	143	Varëse rrobash (koke prifti) metalike	Copë	60	2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës
37	156	Ekspozitorë	Copë	3	2 (dy) muaj pas

					nënshkrimit të kontratës
--	--	--	--	--	--------------------------

III.2.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën shkresën nr. 3817/16 prot, datë 06.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 227/4 prot, datë 09.02.2026, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe rivlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar se oferta e shoqërisë “ERALD” SHPK është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte më datë 06.01.2026, KVO-ja nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) i është drejtuar operatorit ekonomik “ERALD” SHPK me kërkesë për sqarim për ofertën anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së, i ndryshuar.

III.2.4. Në përgjigje të kërkesës së KVO, më datë 08.01.2026, me shkresën “Kthim përgjigje mbi argumentimin e ofertës së shoqërisë “Erald” sh.p.k, vlerësuar anomalisht e ulët” datë 08.01.2026, operatori ekonomik “ERALD” SHPK ka paraqitur shpjegimet e tij me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës së tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, duke argumentuar si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj të ardhur më datë 06.01.2026 e mbërritur në rrugë elektronike në faqen zyrtare të APP-së të shoqërisë “Erald” sh.p.k, ku kërkohet informacion, në mbështetje të nenit 93 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të nenit 82 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në lidhje me procedurën e prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, mallra, kontratë, me objekt: Loti 1: “Blerje orendish për mobilim”, me nr. REF-52892-06-30-2025, me fond limit 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH, ku jemi njoftuar se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është konstatuar se oferta e paraqitur nga ana jonë është anomalisht e ulët, nga ana e institucionit tuaj po ju argumentojmë si më poshtë vijon:

Firma “Erald” sh.p.k është një nga firmat prodhuese dhe tregtuese të mobiljeve me një aktivitet prej afro 25 vitesh në fushën e mobiljeve prej druri, hekuri dhe materialeve ndihmëse. “Erald” sh.p.k u themelua në vitin 1997 “ERALD” është sot një standard i designit e mobilimit në Shqipëri me një eksperiencë afro 29 vite.

Ne kemi bërë kërkimin e stilit e kualitetit, misionin tonë kryesor, duke u rinovuar vazhdimisht në ofertat tona për të interpretuar sa më mirë stilet e jetës e linjat më moderne të designit bashkëkohor.

Design është pjesë e kulturës prodhuese e tregtuese të ERALD, me objektiv kryesor realizimin e kërkesave të klientit.

Ndërtesa moderne e ekspozitës dhe zyrat funksionale, prej 4000 m² dhe me një sipërfaqe magazinimi prej 12.000 m², janë të vendosura në Durrës, Nikel, Qereke, rruga Nacionale Tiranë - Fushë Krujë, km 13, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30.

Këtu mund të gjeni gjithçka mbi mobilimin e shtëpive dhe zyrave.

Qëllimi dhe Objektivat tona

Synimi kryesor konsiderojmë zgjerimin e tregut dhe plotësimin e kërkesave të tregut me çdo lloj mobilie dhe për çdo lloj hapësire si: shtëpi, hotele, bare, zyra, shkolla etj.

Kompania ofron shërbime profesionale dhe zgjidhje të përballeshme për mobilje zyre. Ne ofrojmë vlerën më të mirë, duke përfshirë:

- *Kosto paraprake konkurruese*
- *Produkte cilësore*
- *Përvoja dhe shërbimi*
- *Inovacioni*
- *Ergonomi*

Ekipi ynë përbëhet nga staf i përkushtuar, entuziast dhe me përvojë, duke përfshirë:

- *Menaxherët e projektit*
- *Specialistë të mobiljeve*
- *Inxhinierët e mobiljeve*

Shoqëria “ERALD” sh.p.k përbëhet nga një staf i kualifikuar dhe i përbërë prej një mesatare prej 46 personash, të cilët janë të përkushtuar në punën që ata bëjnë.

METODOLOGJIA E PROPOZUAR

Çdo projekt është pjesë e mobilimit sipas kërkesave të klientit.

Implementimi i Projektit

Shoqëria “Erald” sh.p.k bashkëpunon me inxhinierë mobiliesh, profesionistë për realizimin e të gjitha nismave dhe aktiviteteve që bëjnë të mundur arritjen e objektivave të projektit mobilimit kërkesave të klientit, projekteve të ofruara nga vetë klienti apo dhe atyre të ofruara nga ana jonë.

Hapat kryesorë për Metodologjinë e ndjekur nga kompania jonë përfshijnë:


1. Proçesi i Menaxhimit

Aktiviteti i parë përfshin sqarimin e detyrës me klientin, krijimin e një liste (paraprake) të produkteve kryesore që do të ofrohen dhe përcaktimin e propeseve dhe afateve të punës së bashku me klientin.

2. Specifikimet dhe përgatitja e porosisë.

Konceptimi i kërkesave të klientit do të përmbyllet në një dokument të detajuar mbi nevojat e klientit.

Përgatitja e vizatimeve dhe specifikimeve të detajuara që tregojnë zonat e ndryshme të projektit, veçoritë e tyre, materialet që do të përdoren, etj.



2.1 PROJEKTIMI

Pas shqyrtimit të specifikimeve të dhëna në dokumentacion, grupi i projektimit i përbërë nga një arkitektë dhe dy inxhinier fillon punën për skicimin e produkteve të listuara. Duke respektuar specifikimet bëhet ndërtimi 3-dimensional i objekteve dhe dimensionimi i tyre nga arkitektët ku më pas i dorëzohen inxhinierit për fazën e zbërthimit. Pas zbërthimit të produktit

në elementë fillon programimi i tyre në sistem minifix ose lamello cabineo. Të gjithë proceset e sipërpërmendura kanë një afat kohor prej 5 ditësh kalendarike.



Pas zbërthimit të elementeve, duke u bazar në mënyrën se si do të bëhet montimi, planifikohet dhe programohet forimi i secilit element të objektit.

2.2. PRODHIMI

Pas përfundimit të skicave dhe programimit, puna kalon në repartet e prodhimit. Aty do të bëhet si fillim prerja e materialit sipas dimensioneve dhe bordimi i elementeve. Pasi elementët të jenë borduar bëhet kalimi i tyre në makinerinë e posaçme që bën dhe forimin e secilit element sipas programimit nga inxhinieri. Me përfundimin e këtij procesi elementët janë gati për montim. Montimi fillon me vënjen e aksesorëve minifix ose lamello cabineo si dhe të menteshave. Pasi vendosen të gjithë aksesorët bëhet e mundur montimi i elementëve për të ndërtuar objektin.


2.2.1. PRERJE

Pasi kemi përfunduar të gjithë projektimin, skicat kalojnë në repartin e mobilerisë, ku hapi i parë është prerja e elementëve sipas dimensioneve të përcaktuara. Elementët të gjitha programohen paraprakisht në formatit e materialit të përcaktuar për tu përdorur, për të kaluar më pas në prerjen fizike të elementëve.



2.2.2. Bordimi

Pasi mbaron prerja e elementeve, secill prej tyre kalon në procesin e bordimit, ku bëhet bordimi sipas planifikimit të bërë nga inxhinieri. Në këtë proces bëhet veshja e aiiësoreve të elementeve me PVC.



2.2.3. Forim

Pasi çdo element ka kaluar në procesin e bordimit, ato kalojnë në makinerinë e forimit, ku bëhet punimi CNC me systemin Minifix ose lamello cabineo.

2.2.4. MONTIMI

Ne fazën e fundit të këtij procesi bëhet montimi i elementeve të përpunuara. Si fillim në çdo element vendosen aksesore, të cilët përfshijnë aksesoret minifix ose lamello cabineo dhe menteshat. Pasi të bëhet plotësimi i të gjithë elementeve përbërës, fillon montimi I tyre sëbashku për të ndërtuar objektin i cili përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3. KOLAUDIMI

Në këtë fazë objekti ka marrë formën e plotë dhe kryhet kontrolli nga përgjegjshi i prodhimit I cili ushtron kontroll visual të objektit, duke bërë të mundur korigjimin e difekteve pamore në rast se konstatohen dhe regjistrim të aksesorëve të montuar. Pasi është marrë konfirmimi që objekti I plotëson të gjitha kushtet, bëhet paketimi me amballazh.

2.4. TRANSPORTI



Të gjithë produktet e prodhuara janë të certifikuara sipas standartit ISO.

Menaxhimi i porosisë

Një sistem kontrolli i orarit do të zbatohet për të maiTë një vlerësim real të orarit, i cili do t'i raportohet rregullisht Klientit.

3. Instalimi

Si furnizues, stafi ynë do të paketojë, instalojë dhe montojë produktet në vendndodhjet e Klientit duke marrë parasysh sa vijon:

- Siguroni një (1) pikë kontakti për të gjitha instalimet;
- Mblidhni Produktet sipas kërkesës së Klientit;
- Montoni Produktet duke ndjekur udhëzimet e specialistëve;
- Sigurimi i ndërprerjes minimale për Klientin;
- Të jetë në përputhje me kërkesat e kodeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve

4. Implementimi i projektit

Pas përfundimit të instalimit, ekipi i Mobilerisë “Erald” dhe ekipi i klientëve do të kryejnë një inspektim përfundimtar dhe do të identifikojnë çdo mangësi që do të riparohet. Ne do të punojmë me një plan pune për të riparuar ose zgjidhur mangësitë me afate kohore për klientin, nëse kërkohet

Cilësia e produkteve është në përputhje me standartet europiane, dhe për dekada me radhë kanë krijuar ambiente të brendshme për t’iu përshtatur do nevojë, Kjo traditë është e mbushur në pdo produkt dhe detaj, dhe merr frymë në copa moderne, klasike, elegante dhe unike të mobilieve.

“ERALD” sh.p.k zbulon karakterin e një hapësire, duke e shtypur atë me dëshirat e atyre që banojnë në të, Ajo merr frymë në dhomat e gjumit, dhomat e jetesës dhe dhomat e ngrënies, ndërsa i pasuron ato me prekje unike.

“ERALD” SH.P.K është një kompani me menaxhim të lartë dhe të afte, me një staf me përvojë në shërbim të klientit, gjithmone në plan të parë për ne.

Objektivi kryesor, plotësimi i dëshirave të klientit.

Arredim me design e kualitet të lartë.

Leader në interpretimin e linjave bashkohore të stili.

Shoqëria “Erald” sh.p.k është e certifikuar nga organizmat ndërkombëtare në lidhje me cilësinë e produkteve që ajo ofron në treg si dhe produktet që kjo shoqëri ofron janë konform të gjitha standarteve të Komunitetit Europian përsa i përket cilësisë.

Këtë fakt e tregojnë certifikatat që janë lëshuar në emër të kësaj kompanie, sikurse është ajo ISSO 9001-2008 dhënë shoqërisë lidhur me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve që shoqëria ofron.

Teknologjia e përdorur nga ana e kësaj firme në prodhimin e mobiljeve është një teknologji shumë

e përparuar dhe e avancuar.

Ambjentet të cilat ajo ka në përdorim për prodhimin e mobiljeve, krijojnë kushte lehtësuese për punëtorët dhe prodhimin e mobiljeve.

Ambjentet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues, janë ambiente të ndri uara mirë duke lejuar shfrytëzimin maksimal të dritës natyrale, gjë e cila ndikon në rendimentin në punë të punëtorëve.

Zona gjeografike, në të cilën është pozicionuar shoqëria krijojnë kushte lehtësuese për gjetjen e krahut të lirë të punës, me pmime më të lira se në zona të tjera si Tirana, Durrësi etj.

Duke qenë se larmia e produkteve është e ndryshme, të jep miindësinë për një shfrytëzim në maksimum të lëndëve të para, pasi edhe prodhimi do të fillojë nga objektet me përmasa të mëdha duke vazhduar deri tek ato me përmasa më të vogla.

Si pasojë edhe mbetjet teknologjike ndoshta mund të shkojnë edhe më pak se 15 %, që ne kemi parashikuar në preventive.

Për këto artikuj ka mundësi maksimale edhe për një orgazimim të përsosur të punës, pasi bën një ndarje në mes të reparteve të punës (prerjes, montimit dhe llustrimit).

Firma ka siguruar lëndë e parë nëpërmjet importimit si dhe tregjeve të ndryshme në Shqipëri me çmime tepër konkurniese.

Për të gjitha këto arsye që ne shpjeguar më lart mendojmë se kemi dhënë një ofertë optimal për artikujt që kërkohen.

Më poshtë po japim kosto të artikujve, të dhënë ne ofertën e shoqërisë “Erald” sh.p.k si dhe do të gjeni faturat e blerjeve të mallit.

KOSTO TË ARTIKUJVE

...”.

III.2.5. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet 8 ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. [....]”.

III.2.6. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPPsë, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPPsë.”.

III.2.7. Nisur nga përcaktimet e nenit 93, pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nga shqyrtimi i kufirit monetar të procedurës së prokurimit e cila është një procedurë prokurimi mbi kufirin e lartë monetar dhe nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 21.316.800 lekë pa TVSH, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin

mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën.

Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve 15 është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjisllacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e furnizimit të produkteve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i linden autoritetit nga moskryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e furnizimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “*Qëllimi*” i ligjit nr.162/2020 “**Për Prokurimin Publik**”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të

ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.8. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “ERALD” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 08.01.2026 me lëndë “Kthim përgjigje mbi argumentimin e ofertës së shoqërisë “Erald” sh.p.k, vlerësuar anomalisht e ulët” ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë.

Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: “Firma “Erald” sh.p.k është një nga firmat prodhuese dhe tregtuese të mobiljeve me një aktivitet prej afro 25 vitesh në fushën e mobiljeve prej druri, hekuri dhe materialeve ndihmëse.

“Erald” sh.p.k u themelua në vitin 1997 “ERALD” është sot një standard i designit e mobilimit në Shqipëri me një eksperiencë afro 29 vite.

Ne kemi bërë kërkimin e stilit e kualitetit, misionin tonë kryesor, duke u rinovuar vazhdimisht në ofertat tona për të interpretuar sa më mirë stilet e jetës e linjat më moderne të designit bashkëkohor.

Design është pjesë e kulturës prodhuese e tregtuese të ERALD, me objektiv kryesor realizimin e kërkesave të klientit.

Ndërtesa moderne e ekspozitës dhe zyrat funksionale, prej 4000 m² dhe me një sipërfaqe magazinimi prej 12.000 m², janë të vendosura në Durrës, Nikel, Qereke, rruga Nacionale Tiranë - Fushë Krujë, km 13, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30.

Këtu mund të gjeni gjithçka mbi mobilimin e shtëpive dhe zyrave.

Qëllimi dhe Objektivat tona

Synimi kryesor konsiderojmë zgjerimin e tregut dhe plotësimin e kërkesave të tregut me çdo lloj mobilie dhe për çdo lloj hapësire si: shtëpi, hotele, bare, zyra, shkolla etj.

Kompania ofron shërbime profesionale dhe zgjidhje të përbalueshme për mobilje zyre. Ne ofrojmë vlerën më të mirë, duke përfshirë:

- *Kosto paraprake konkurruese*
- *Produkte cilësore*
- *Përvoja dhe shërbimi*
- *Inovacioni*
- *Ergonomi*

Ekipi ynë përbëhet nga staf i përkushtuar, entuziast dhe me përvojë, duke përfshirë:

- *Menaxherët e projektit*
- *Specialistë të mobiljeve*
- *Inxhinierët e mobiljeve*

Shoqëria “ERALD” sh.p.k përbëhet nga një staf i kualifikuar dhe i përbërë prej një mesatare prej 46 personash, të cilët janë të përkushtuar në punën që ata bëjnë.

METODOLOGJIA E PROPOZUAR

Çdo projekt është pjesë e mobilimit sipas kërkesave të klientit.

Implementimi i Projektit

Shoqëria “Erald” sh.p.k bashkëpunon me inxhinierë mobiliesh, profesionistë për realizimin e të gjitha nismave dhe aktiviteteve që bëjnë të mundur arritjen e objektivave të projektit mobilimit kërkesave të klientit, projekteve të ofruara nga vetë klienti apo dhe atyre të ofruara nga ana jonë.

Hapat kryesorë për Metodologjinë e ndjekur nga kompania jonë përfshijnë:


1. Proçesi i Menaxhimit

Aktiviteti i parë përfshin sqarimin e detyrës me klientin, krijimin e një liste (paraprake) të produkteve kryesore që do të ofrohen dhe përcaktimin e propeseve dhe afateve të punës së bashku me klientin.

2. Specifikimet dhe përgatitja e porosisë.

Konceptimi i kërkesave të klientit do të përmbyllet në një dokument të detajuar mbi nevojat e klientit.

Përgatitja e vizatimeve dhe specifikimeve të detajuara që tregojnë zonat e ndryshme të projektit, veçoritë e tyre, materialet që do të përdoren, etj.



2.1 PROJEKTIM

Pas shqyrtimit të specifikimeve të dhëna në dokumentacion, grupi i projektimit i përbërë nga një arkitektë dhe dy inxhinier fillon punën për skicimin e produkteve të listuara. Duke respektuar specifikimet bëhet ndërtimi 3-dimensional i objekteve dhe dimensionimi i tyre nga arkitektët ku më pas i dorëzohen inxhinierit për fazën e zbërthimit. Pas zbërthimit të produktit në elementë fillon programimi i tyre në sistem minifix ose lamello cabineo. Të gjithë proceset e sipërpërmendura kanë një afat kohor prej 5 ditësh kalendarike.



Pas zbërthimit të elementeve, duke u bazar në mënyrën se si do të bëhet montimi, planifikohet dhe programohet forimi i secilit element të objektit.

2.2. PRODHIMI

Pas përfundimit të skicave dhe programimit, puna kalon në repartet e prodhimit. Aty do të bëhet si fillim prerja e materialit sipas dimensioneve dhe bordimi i elementeve. Pasi elementët të jenë borduar bëhet kalimi i tyre në makinerinë e posaçme që bën dhe forimin e secilit element sipas programimit nga inxhinieri. Me përfundimin e këtij procesi elementët janë gati për montim. Montimi fillon me vënjen e aksesorëve minifix ose lamello cabineo si dhe të menteshave. Pasi vendosen të gjithë aksesorët bëhet e mundur montimi i elementëve për të ndërtuar objektin.


2.2.1. PRERJE

Pasi kemi përfunduar të gjithë projektimin, skicat kalojnë në repartin e mobilerisë, ku hapi i parë është prerja e elementëve sipas dimensioneve të përcaktuara. Elementët të gjitha programohen paraprakisht në formatit e materialit të përcaktuar për tu përdorur, për të kaluar më pas në prerjen fizike të elementëve.



2.2.2. Bordimi

Pasi mbaron prerja e elementeve, secill prej tyre kalon në procesin e bordimit, ku bëhet bordimi sipas planifikimit të bërë nga inxhinieri. Në këtë proces bëhet veshja e ariësoreve të elementeve me PVC.



2.2.3. Forim

Pasi çdo element ka kaluar në procesin e bordimit, ato kalojnë në makinerinë e forimit, ku bëhet punimi CNC me systemin Minifix ose lamello cabineo.

2.2.4. MONTIMI

Ne fazën e fundit të këtij procesi bëhet montimi i elementeve të përpunuara. Si fillim në çdo element vendosen aksesorë, të cilët përfshijnë aksesorët minifix ose lamello cabineo dhe menteshat. Pasi të bëhet plotësimi i të gjithë elementeve përbërës, fillon montimi I tyre sëbashku për të ndërtuar objektin i cili përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3. KOLAUDIMI

Në këtë fazë objekti ka marrë formën e plotë dhe kryhet kontrolli nga përgjegjasi i prodhimit i cili ushtron kontroll visual të objektit, duke bërë të mundur korigjimin e difekteve pamore në rast se konstatohen dhe regjistrim të aksesorëve të montuar. Pasi është marrë konfirmimi që objekti i plotëson të gjitha kushtet, bëhet paketimi me amballazh.

2.4. TRANSPORTI



Të gjithë produktet e prodhuara janë të certifikuara sipas standartit ISO.

Menaxhimi i porosisë

Një sistem kontrolli i orarit do të zbatohet për të maiTë një vlerësim real të orarit, i cili do t'i raportohet rregullisht Klientit.

3. Instalimi

Si furnizues, stafi ynë do të paketojë, instalojë dhe montojë produktet në vendndodhjet e Klientit duke marrë parasysh sa vijon:

- Siguroni një (1) pikë kontakti për të gjitha instalimet;
- Mblidhni Produktet sipas kërkesës së Klientit;
- Montoni Produktet duke ndjekur udhëzimet e specialistëve;
- Sigurimi i ndërprerjes minimale për Klientin;
- Të jetë në përputhje me kërkesat e kodeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve

4. Implemtimi i projektit

Pas përfundimit të instalimit, ekipi i Mobilerisë “Erald” dhe ekipi i klientëve do të kryejnë një inspektim përfundimtar dhe do të identifikojnë çdo mangësi që do të riparohet. Ne do të punojmë me një plan pune për të riparuar ose zgjidhur mangësitë me afate kohore për klientin, nëse kërkohet

Cilësia e produkteve është në përputhje me standartet europiane, dhe për dekada me radhë kanë krijuar ambiente të brendshme për t'iu përshtatur do nevojë, Kjo traditë është e mbushur në pdo produkt dhe detaj, dhe merr frymë në copa moderne, klasike, elegante dhe unike të mobilieve.

“ERALD” sh.p.k zbulon karakterin e një hapësire, duke e shtypur atë me dëshirat e atyre që banojnë në të, Ajo merr frymë në dhomat e gjumit, dhomat e jetesës dhe dhomat e ngrënies, ndërsa i pasuron ato me prekje unike.

“ERALD” SH.P.K është një kompani me menaxhim të lartë dhe të afte, me një staf me përvojë në shërbim të klientit, gjithmone në plan të parë për ne.

***Objektivi kryesor,** plotësimi i dëshirave të klientit.*

***Arredim** me design e kualitet të lartë.*

Leader në interpretimin e linjave bashkohore të stili.

Shoqëria “Erald” sh.p.k është e certifikuar nga organizmat ndërkombëtare në lidhje me cilësinë e produkteve që ajo ofron në treg si dhe produktet që kjo shoqëri ofron janë konform të gjitha standarteve të Komunitetit Europian për sa i përket cilësisë.

Këtë fakt e tregojnë certifikatat që janë lëshuar në emër të kësaj kompanie, sikurse është ajo ISSO 9001-2008 dhënë shoqërisë lidhur me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve që shoqëria ofron.

Teknologjia e përdorur nga ana e kësaj firme në prodhimin e mobiljeve është një teknologji shumë

e përparuar dhe e avancuar.

Ambjentet të cilat ajo ka në përdorim për prodhimin e mobiljeve, krijojnë kushte lehtësuese për punëtorët dhe prodhimin e mobiljeve.

Ambjentet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin prodhues, janë ambiente të ndri uara mirë duke lejuar shfrytëzimin maksimal të dritës natyrore, gjë e cila ndikon në rendimentin në punë të punëtorëve.

Zona gjeografike, në të cilën është pozicionuar shoqëria krijojnë kushte lehtësuese për gjetjen e krahut të lirë të punës, me pime më të lira se në zona të tjera si Tirana, Durrësi etj.

Duke qenë se larmia e produkteve është e ndryshme, të jep miëndësinë për një shfrytëzim në maksimum të lëndëve të para, pasi edhe prodhimi do të fillojë nga objektet me përmasa të mëdha duke vazhduar deri tek ato me përmasa më të vogla.

Si pasojë edhe mbetjet teknologjike ndoshta mund të shkojnë edhe më pak se 15 %, që ne kemi parashikuar në preventive.

Për këto artikuj ka mundësi maksimale edhe për një orgazimim të përsosur të punës, pasi bën një ndarje në mes të reparteve të punës (prerjes, montimit dhe ilustrimit).

Firma ka siguruar lëndë e parë nëpërmjet importimit si dhe tregjeve të ndryshme në Shqipëri me çmime tepër konkurruese.

Për të gjitha këto arsye që ne shpjeguam më lart mendojmë se kemi dhënë një ofertë optimale për artikujt që kërkohen.

Më poshtë po japim kosto të artikujve, të dhënë ne ofertën e shoqërisë “Erald” sh.p.k si dhe do të gjeni faturat e blerjeve të mallit. ... “.

*Përveç kësaj, KPP vëren se ankimesi në mbështetje të deklarime më sipër ka paraqitur **Analizë kosto loti 1** për të gjithë artikujt objekt-prokurimi, ku përfshihet lënda e parë e*

nevojshme që do të përdoret për prodhimin e artikujve, sasitë e nevojshme të lëndës së parë që do të përdoret për prodhimin e produkteve referuar specifikimeve teknike të këtyre produkteve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, koston e blerjes së lëndës së parë, koston e makinerive dhe të puntorise, shpenzimet administrative dhe fitimin.

Gjithashtu ankimuesi bashkalidhur analizës së koston për secilin nga artikujt objekt prokurimi të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*”, **LOTI 1 “BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM”** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka paraqitur edhe deklarata doganore importi dhe fatura tatimore shitje për të vërtetuar çmimin e blerjes për të gjithë artikujt lëndë e parë të nevojshme për prodhimin e produkteve objekt prokurimi.

KPP gjykon se, ankimuesi në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër të argumentojë në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementët favorizues që disponon të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizimi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, lidhjet me prodhuesit dhe mundësisë së ofertimit me çmime të ulëta, duke i provuar të gjitha deklaratimet e tij me dokumentacion justifikues si fatura tatimore, deklarata doganore, ka paraqitur edhe analizën e detajuar të koston në përmbushje të gjermës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së koston për të gjitha elementet. Në këtë kuptim, KPP gjykon se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së.

Lidhur me argumentet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave drejtuar ankimuesit se: “*OE nuk ka argumentuar / provuar me dokumente shkresore, plotesimin e pikave b, c, ç te parashikuara ne nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” pika 2,...*” KPP gjykon se ky pretendim nuk qëndron, pasi referuar shkresës “*Kthim përgjigje mbi argumentimin e ofertës së shoqërisë “Erald” sh.p.k, vlerësuar anomalisht e ulët*” datë 08.01.2026, operatori ekonomik “*ERALD*” SHPK ka argumentuar zgjidhjet teknike të përzgjedhura prej tij për prodhimin e produkteve të ofertuara, origjinalitetin e produkteve të ofruara prej tij dhe pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushëm e mjedisit, në fushën sociale dhe në fushën e marrdhënieve të punës.

Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) është shprehur se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t’i skualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni European, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit European (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t’i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore, nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rinegociuar fondin limit, pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve, apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni European ka deklaruar, se ky është një problem i hasur posaçërisht

në industrinë e ndërtimit. Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*ERALD*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “*MUCA*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-52889-06-30-2025*, me objekt: “*Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025*”, me fond limit 37,618,436 (*tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (*treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë*) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: *REF-52892-06-30-2025*, me objekt: “*Blerje orendish për mobilim*”, me fond limit të lotit 32,216,511 (*tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (*treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë*) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*ERALD*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-52889-06-30-2025*, me objekt: “*Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025*”, me fond limit 37,618,436 (*tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (*treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë*) euro pa TVSH, Loti 1, me numër reference të lotit Nr: *REF-52892-06-30-2025*, me objekt: “*Blerje orendish për mobilim*”, me fond limit të lotit 32,216,511 (*tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (*treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë*) euro pa TVSH zhvilluar me datë 31.07.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*ERALD*” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të pjesës së tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*ERALD*” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

